




REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

R A P O R T I
I PUNËS SË GJYKATËS SUPREME TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
PËR VITIN 2019



HYRJE

Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut paraqet kategorinë kushtetuese pozita e të cilës krahas gjykatave tjera në pushtetin gjyqësor shënohet në nenin 101 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, si gjykatë më e lartë në Republikë që siguron qëndrimin unik në zbatimin e ligjeve nga ana e gjykatave.

Sipas Ligjit për gjykatat, në suaza të kompetencës lëndore të saj, Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut si gjykatë më e lartë vendos në shkallë të tretë dhe të fundit ndaj ankesave kundër vendimeve të gjykatave të apelit, ndaj mjeteve të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve të plotfuqishme të gjykatave dhe vendimeve të këshillave të tyre kur ajo është përcaktuar me ligj, për ndeshje të kompetencave dhe përcaktimin e kompetencës vendore, vendos ndaj kërkesës për cenimin e të drejtës së gjykimit në afatin e arsyeshëm, në shkallën e parë dhe të dytë, në procedurë të përcaktuar me ligj para gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në përputhje me rregullat dhe principet e përcaktuara me Konventën Evropiane për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore dhe duke u nisur nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut, si dhe të kryejë punë të tjera të përcaktuara me ligj.

Kompetencën e saj kjo Gjykatë e realizon përmes **Sektorit të veprave penale, Sektorit të veprave civile, Sektorit për gjykim në afat të arsyeshëm, Sektorit të praktikës gjyqësore, këshillave të specializuara për procedimin** sipas kërkesave për mbrojtjen e lirive themelore dhe të drejtën e garantuar me Kushtetutë dhe sipas ankesave nga kandidatët që nuk janë zgjedhur gjyqtarë ose Kryetar të Gjykatës.

Kompetencën e saj për harmonizimin e praktikës gjyqësore, Gjykata supreme e realizon në **Mbledhjen e përgjithshme** përmes konstatimit të mendimeve juridike parimore dhe qëndrimeve parimore dhe nëpërmjet përgatitjes së sentencave të miratuara në mbledhjet e sektorëve gjyqësor, që publikohen në ueb faqen e Gjykatës. Po ashtu, harmonizimi i praktikës gjyqësore realizohet dhe përcillet edhe përmes Sektorit të praktikës gjyqësore.

Në plotësimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore edhe në vitin 2019, Kryetari dhe gjyqtarët tjerë të Gjykatës supreme, kanë marrë pjesë në punën e këshillave, në Mbledhjet e përgjithshme, në mbledhjet e gjyqtarëve, në mbledhjet e sektorëve, si dhe në aktivitete të tjera në përputhje me ligjin, të orientuara drejt zbatimit më efikas të Kushtetutës, ligjeve dhe marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare.

Gjyqtarët gjatë vitit raportues, krahas angazhimit të lëndëve kanë marrë pjesë edhe në trupa punues dhe në komisione për shumë projekte ligjore, si dhe në seminare, edukime dhe udhëtime studiuëse.

Në Gjykatën supreme për përdorimin dhe avancimin e sistemit të automatizuar kompjuterik për drejtimin me lëndët gjyqësore, me Vendim të Kryetarit të Gjykatës formohet dhe funksionon Trupi punues për standardizimin e procedurave në gjykatat që është i karakterit të përhershëm dhe të sesioneve të përhershme, në të cilin kryeson gjyqtar i Gjykatës supreme.

Sipas Ligjit për gjykatat, në Gjykatën supreme është formuar dhe funksionon qendra për informatikë me bazën e të dhënave për teknologjinë informatike kompetente për drejtimin teknik me sistemin e automatizuar kompjuterik për drejtimin me lëndët gjyqësore dhe bazat e të dhënave që burojnë nga puna e gjykatave.

Sipas Ligjit për shërbimin gjyqësor, në suaza të Gjykatës funksionon edhe Këshilli i shërbimit gjyqësor në përbërje dhe kompetenca të përcaktuara me Ligjin dhe Seksionin e çështjeve administrative të Këshillit, ndërsa kryetar i këshillit është administratori gjyqësor i Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Vëllimi dhe intensiteti i punës është shprehur nëpërmjet të dhënave për veprimin me lëndë të llojeve konkrete gjatë tërë vitit në sektorët dhe këshillat e specializuar që janë paraqitur edhe masa dhe aktivitete të tjera, që janë ndërmarrë në këtë Gjykatë, si gjykatë më e lartë në Republikën.

RESURSE NJERËZORE

Me Vendim të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, është përcaktuar që funksionin e gjyqtarit në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut ta kryejnë **25 gjyqtarë**, megjithatë si vitet e kaluara edhe këtë vit gjyqtarit që është zgjedhur anëtarë i Këshillit gjyqësor dhe gjyqtarit që është zgjedhur në Gjykatën kushtetuese, vendet e punës si gjyqtarë u janë vendosur në pritje.

Në shtator të vitit 2019, Kryetarit të Gjykatës dhe një gjyqtari u është shqiptuar masë, largimi i përkohshëm nga kryerja e funksionit të Kryetarit, respektivisht funksionit të gjyqtarit, dhe u zgjodh UD Kryetar i Gjykatës.

Me kërkesë në Mbledhjen e përgjithshme të Gjykatës supreme, me Vendimin e Këshillit gjyqësor u zgjerua numri i vendeve të punës së gjyqtarëve dhe u konstatua se funksionin e gjyqtarit në Gjykatën supreme do ta kryejnë **28 gjyqtarë**.

Në bazë të këtij Vendimi nga ana e Këshillit gjyqësor, është publikuar shpallje për gjashtë gjyqtarë, megjithatë deri në fund të vitit zgjedhja nuk u realizua plotësisht, ndërsa në muajin e dhjetë të vitit 2019 është zgjedhur një gjyqtar në Gjykatën supreme.

Nga e ekspozuara më lartë buron se, kjo Gjykatë në vitin raportues ka funksionuar me një përbërje jo të plotë të gjyqtarëve prej vetëm **17 gjyqtarëve** gjë kjo, që ishte në kufij të minimumit të nevojitur për funksionimin normal të Gjykatës, pavarësisht nga kompetenca e saj, punën në mbledhjet e përgjithshme, punën e katër sektorëve, Sektorin e veprave penale, Sektorin e veprave civile, Sektorin e gjykimit në afat të arsyeshëm dhe Sektorin e praktikës gjyqësore, që shkaktonte numër të lartë të përjashtimeve dhe nevojën për riorganizimin dhe ri sistemimin me angazhimin e vazhdueshëm edhe të bashkëpunëtorëve profesional gjyqësor në më shumë këshilla.

Sipas Ligjit për gjykatat, Ligjit për shërbimin gjyqësor, Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe Planin vjetor për punësim është përcaktuar organizimi i brendshëm, vendet e punës dhe numri i realizuesve që nevojiten për realizimin e kompetencave në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nga numri i paraparë i nëpunësve gjyqësorë në Rregulloren, që sipas Ligjit për shërbimin gjyqësor klasifikohen në tri grupe (udhëheqësi, profesionistë dhe ndihmës nëpunës profesional gjyqësor), mund të konstatohet se numri i nëpunësve gjyqësorë në këtë gjykatë aspak nuk i plotëson nevojat sipas vëllimit dhe ndërlikimin e kompetencës së Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut si gjykatë më e lartë e shtetit.

Në periudhën e kaluar konstatohet largimi i vazhdueshëm dhe zbrazje e vendeve të punës nga të gjitha kategoritë e nëpunësve gjyqësorë për shkak të largimit në institucione tjera, shpërngulje dhe me bazën për pensionim.

Duke qenë se vendet e tilla të zbrazëta të punës nuk plotësoheshin me kohë, për shkak të mospranimit të miratimit dhe pëlqimit nga Ministria e financave për publikimin e shpalljeve, mungesa e të punësuarve kompensohet me orarin e punës, për shkak të së cilës një periudhë më të gjatë kohore çdo i punësuar kryen shumë obligime. Në dhjetor të vitit 2019 pas pëlqimit të pranuar, janë realizuar 12 – dymbëdhjetë punësime me publikimin e shpalljes publike edhe atë për vendet e punës Këshilltarë gjyqësorë 5 – pesë realizues, për bashkëpunëtorë të lartë gjyqësor 4 – katër realizues, për vend pune referent i lartë gjyqësor daktilografi 2 – dy realizues dhe për referent më i ri gjyqësor 1 – një realizues.

Nëse merret parasysh edhe periudha paraprake kur 5 (pesë) nëpunës të administratës gjyqësore, të punësuar në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë kanë kaluar në Gjykatën administrative dhe prej atëherë vendet e tyre të punës janë të pa plotësuara, përfshirë edhe vendet e zbrazëta të punës me bazën e pensionimit, tregon se numri i nëpunësve gjyqësor në këtë gjykatë aspak nuk i plotëson nevojat. Për momentin, në të tria sportelet, në atë penale, civile dhe në atë për gjykim në afat të arsyeshëm, punojnë 6 (gjashtë) ndihmës nëpunës profesional gjyqësor.

Gjykata supreme vitin 2019, e përfundoi me **67** nëpunës të punësuar gjyqësor të kategorisë udhëheqës, nëpunës profesional dhe ndihmës profesional gjyqësor, 5 – pesë pjesëtarë të policisë gjyqësore dhe 6 – gjashtë të punësuar në shërbimin teknik. Ky numër i zvogëluar i nëpunësve gjyqësor nuk përputhet me vëllimin e punës dhe me numrin e gjyqtarëve.

VENDIMMARJA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga viti 2018 kanë mbetur të pakryera **1422** lëndë, të reja të pranuar **në vitin 2019** janë **2002** lëndë, që do të thotë se Gjykata ka punuar gjithsej **3422** lëndë nga të gjitha llojet me 5 lëndë përsëri në punë dhe pa 7 lëndë që janë evidentuar gabimisht. Gjatë vitit janë kryer **2167**, ndërsa kanë mbetur të pakryera **1255** lëndë. Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut e ka tejkaluar numrin e rritjes së lëndëve dhe ka zvogëluar numrin e mbetur të lëndëve për **165** lëndë.

Raporti sipas sektorëve për periudhën nga 01.01.2019 deri më 31.12.2019

Sfera	Sfera civile						
Lloji i lëndës							
Nënllloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuara gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Lëndë të ndryshme civile dhe ndeshje të kompetencave të ndryshme	16	225	0	1	240	225	15
Gjithsej – lloji i lëndës	16	225	0	1	240	225	15
Lloji i lëndës	Lëndë civile sipas revizionit						
Nënllloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuara gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Konteste civile - revizion	166	243	3	0	412	186	226
Konteste pune - revizion	125	187	0	0	312	118	194
Konteste civile – revizion	639	529	1	4	1165	682	483
Gjithsej – lloji i lëndës	930	959	4	4	1889	980	901
Gjithsej – sfera	946	1184	4	5	2129	1211	918
Sfera	Sfera penale						
Lloji i lëndës							
Nënllloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuara gabimisht	Gjithsej	Të kryera	Kanë mbetur
Lëndë penale të ndryshme	12	53	0	0	65	59	6
Mbrojtje e ligjshmërisë sipas lëndëve penale	23	23	0	0	46	36	10
Zbutje e jashtëzakonshme e dënimit	17	44	0	0	61	53	8
Gjithsej – lloji i lëndës	52	120	0	0	172	148	24
Lloji i lëndës	Shqyrtimi i jashtëzakonshëm i vendimit të plotfuqishëm						
Nënllloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuara gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Shqyrtimi i jashtëzakonshëm i vendimit të plotfuqishëm krimi i organizuar – këshilli prej pesë gjyqtarëve	15	12	0	1	26	15	11
Shqyrtimi i jashtëzakonshëm i vendimit të plotfuqishëm krimi i organizuar – këshilli prej tre gjyqtarëve	1	1	0	0	2	2	0
Shqyrtimi i jashtëzakonshëm i vendimit të plotfuqishëm – këshilli prej pesë gjyqtarëve	92	166	0	0	258	162	96

Shqyrtimi i jashtëzakonshëm i vendimit të plotfuqishëm – këshilli prej tre gjyqtarëve	44	0	0	0	44	44	0
Gjithsej – lloji i lëndës	152	179	0	1	330	223	107
Lloji i lëndës	Lëndë të shkallës së tretë						
Nënloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuara gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Ankesa sipas aktgjykimeve të shkallës së tretë	22	60	0	1	81	58	23
Ankesa sipas aktvendimeve për paraburgim	0	67	0	0	67	67	0
Gjithsej – lloji i lëndës	22	127	0	1	148	125	23
Gjithsej – sfera	226	426	0	2	650	496	154
Sfera	Gjykim në afat të arsyeshëm						
Lloji i lëndës	Gjykim në afat të arsyeshëm – të shkallës së dytë						
Nënloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuara gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Gjykim në afat të arsyeshëm – ankesa	17	130	0	0	147	116	31
Gjithsej – lloji i lëndës	17	130	0	0	147	116	31
Lloji i lëndës	Gjykim në afat të arsyeshëm – të shkallës së parë						
Nënloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuara gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Gjykim në afat të arsyeshëm - Administrative	72	69	0	0	141	73	68
Gjykim në afat të arsyeshëm - Penale	65	62	1	0	128	83	45
Gjykim në afat të arsyeshëm - Civile	81	109	0	0	190	157	33
Gjithsej – lloji i lëndës	218	240	1	0	459	313	146
Gjithsej – sfera	235	370	1	0	606	429	177
Sfera	Sfera administrative						
Lloji i lëndës							
Nënloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuara gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Mbrojtje e ligshmërisë në kontest administrativ	5	4	0	0	9	7	2
Ankesa kundër vendimeve të Gjykatës administrative	10	17	0	0	27	23	4
Gjithsej – lloji i lëndës	15	21	0	0	36	30	6
Gjithsej – sfera	15	21	0	0	36	30	6
Lloji i lëndës	Ankesa kundër vendimeve të KGJRMV						
Nënloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuara gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Ankesa kundër vendimeve të KGJRMV – për zgjedhje	0	1	0	0	1	1	0
Gjithsej – lloji i lëndës	0	1	0	0	1	1	0
Gjithsej	1422	2002	5	7	3422	2167	1255

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Sfera	Administrata gjyqësore						
Lloji i lëndës	Evidenca e administratës gjyqësore						
Nënloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuara gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Lëndë të administratës gjyqësore	2	2187	0	0	2189	2189	0
Lëndë të besueshme të administratës gjyqësore	0	22	0	0	22	22	0
Gjithsej – lloji i lëndës	2	2209	0	0	2211	2211	0
Lloji i lëndës	Parashtresa dhe ankesa						
Nënloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuara gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Qasje të lirë në informacione	0	30	0	0	30	30	0
Evidenca e parashtresave dhe ankesave	0	247	1	0	248	248	0
Gjithsej – lloji i lëndës	0	277	1	0	278	278	0
Gjithsej – sfera	2	2486	1	0	2489	2489	0

Parashtresa, propozime dhe kërkesa tjera nga administrata gjyqësore

Gjatë vitit 2019 në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, janë pranuar gjithsej **248 parashtresa** të evidentuara në Regjistrin UPP.

Prej gjithsej parashtresave të parashtruara të evidentuar në regjistrin UPP, 142 janë kërkesa për kryerjen më të shpejtë të lëndëve, ndërsa 106 janë parashtresa nga qytetarë tjerë, institucione dhe organe tjera

Sipas Rregullores së punës së Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kryetari prej gjithsej 142 kërkesave të pranuar për kryerjen me prioritet të lëndëve, ka miratuar 41, ka refuzuar 27, ndërsa të tjera që kanë ngelur janë informacione për lëndët që janë marrë në punë, respektivisht se procedura për lëndën konkrete është kryer, ndërsa lënda është eskpeduar në gjykatën më të ulët kompetente.

Prej gjithsej parashtresave të dorëzuara të evidentuara në Regjistrin UPP, janë evidentuar 2 parashtresa të Ministrisë së drejtësisë, 10 të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 20 parashtresa të Avokatit të popullit dhe 1 parashtresë të Komitetit të Helsinkit për të drejtat e njeriut, me kërkesë për informacione lidhur me revizion të parashtruar, kohëzgjatjen e procedurës dhe të tjera.

Me rastin e kërkesave të parashtruara sipas bazave të ndryshme të evidentuara në Regjistrin UPP, Gjykata supreme ka vepruar sipas Ligjit për gjykatat, Ligjit për veprim me parashtresa dhe propozime, sipas Rregullores së punës së Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë, sipas Rregullores gjyqësore dhe Ligjit për administrimin e procesionit të lëndëve në gjykata.

Kërkesa për përjashtim – SU – IZZ / 2019

Numri total i kërkesave të parashtruara për përjashtim të gjyqtarit; 103

- numri i kërkesave të parashtruara nga palët për përjashtimin e gjyqtarit; 2
- numri i kërkesave të parashtruara nga palët për përjashtimin e kryetarit të gjykatës më të ulët; 6
- numri i kërkesave të parashtruara nga gjyqtarët e GJSRMV për përjashtimin e gjyqtarit; 95
- numri i kërkesave për përjashtim të parashtruar nga kryetarë të gjykatës drejtuar kryetarit të gjykatës më të lartë; /

VËLLIMI DHE VENDIMARJA SIPAS SEKTORËVE

SEKTORI I VEPRAVE PENALE

Pasqyra totale e punës sipas lëndëve

Gjatë vitit raportues **2019** janë pranuar **425** lëndë, kanë mbetur nga muaji dhjetor i vitit **2018** **225** lëndë, ose gjithsej në punë kanë qenë **650** lëndë sipas të gjitha bazave. Pasqyra e lëndëve gjithsej të kryera e të pakryera me bazë të ndryshme në vitin 2019 është dhënë në **tabelën 1**.

Tabela 1

Lloji i lëndës	Kanë mbetur nga muaji i XII 2018	Të pranuar në vitin 2019	Gjithsej në punë	Të kryera	Të pakryera
VKZH1	-	67	67	67	-
VKZH2	22	59	81	58	23
KVP1	44	-	44	44	-
KVP2	92	166	258	162	96
Kvp-KOK-Kvp	1	1	2	2	-
Kvp-KOK2-Kvp	14	12	26	15	11
VUK	17	44	61	53	8
KZZ	23	23	46	36	10
KR	12	53	65	59	6
Gjithsej	225	425	650	496	154

Numri i gjithsej lëndëve të pakryera të vitit 2019, i përket asaj që një numër i konsiderueshëm i të njëjtëve në Gjykatë janë pranuar në muajin e fundit të vitit raportues, me ç'rast nuk ka qenë e mundur të merren në punë për arsye se kanë qenë të dorëzuar për mendim në Prokurorinë publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Gjatë vitit raportues, gjyqtarët, këshilltarët dhe bashkëpunëtorët e lartë profesional kanë marrë pjesë aktive në seminare, këshillime, konferenca dhe në punëtori.

Struktura e lëndëve të kryera sipas llojit të veprave penale

Struktura e lëndëve sipas llojit të veprave penale sipas kërkesave të parashtruara për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit të plotfuqishëm -**KVP1**, **KVP2**, **Kvp.KOK1** dhe **Kvp.KOK2**, gjithsej 223 lëndë është siç vijon:

Kreu XIV nga KP – Vepra penale kundër jetës dhe trupit

57 lëndë për vepër penale – Vrasje – **neni 123**;

1 lëndë për vepër penale – Vrasje në çast – **neni 125**;

12 lëndë për vepër penale – Lëndimi trupor – **neni 130**;

- 11 lëndë për vepër penale - Lëndimi i rëndë trupor – **neni – 131**;
- 1 lëndë për vepër penale – Pjesëmarrje në rrahje – **neni 132**;
- 1 lëndë për vepër penale – Kërcënimi me mjet i rrezikshëm gjatë rrahjes apo përleshjes – **neni 133**;
- Kreu XV nga KP – Vepra penale kundër lirisë dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit.**
- 1 lëndë për vepër penale – Privimi i kundërligjshëm nga liria – **neni 140**;
- 3 lëndë për vepër penale – Rrëmbimi – **neni – 141**;
- 6 lëndë për vepër penale – Rrezikimi i sigurisë – **neni 144**;
- 1 lëndë për vepër penale – Shkelja e paprekshmërisë së banesës – **neni 145**;
- Kreu XIX i KP – Vepra penale kundër lirisë dhe moralit gjinor**
- 5 lëndë për vepër penale – Dhunimi – **neni 186**;
- 2 lëndë për vepër penale – Kryerja e aktit seksual me person të paaftë – **neni 187**;
- 13 lëndë për vepër penale – Sulmi seksual ndaj të miturit që nuk ka mbushur 14 vjet – **neni 188**;
- 1 lëndë për vepër penale – Kryerja e aktit seksual me keqpërdorim të pozitës – **neni 189**;
- 1 lëndë për vepër penale – Ekspozimi i materialit pornografik të miturit – **neni 193**;
- 2 lëndë për vepër penale – Incesti – **neni 194**
- Kreu XX të KP – Vepra penale kundër martesës, familjes dhe rinisë**
- 3 lëndë për vepër penale – Marrja e të miturit – **neni 198**;
- 1 lëndë për vepër penale – Lënia pas dore dhe keqtrajtimi i personit të mitur – **neni 201**;
- Kreu XXI të KP – Vepra penale kundër shëndetit të njeriut**
- 1 lëndë për vepër penale – Mjekimi i pandërgjegjshëm i të sëmurëve – **neni 207**;
- 57 lëndë për vepër penale – Prodhimi i paautorizuar dhe lëshimi në qarkullim i drogave narkotike, substancave psikotrope dhe pre kursove neni – **215**;
- 2 lëndë për vepër penale – Mundësimi i përdorimit të drogave narkotike – **neni 216**;
- Kreu XXII të KP – Vepra penale kundër mjedisit ajror dhe natyrës**
- 2 lëndë për vepër penale Uzurpimi i paluhajtshmërive – neni **225**;
- Kreu XXIII të KP – Vepra penale kundër pronës**
- 7 lëndë për vepër penale – Vjedhja – **neni 235**;
- 31 lëndë për vepër penale – Vjedhja e rëndë – **neni 236**;
- 34 lëndë për vepër penale – Grabitja – **neni 237**;
- 2 lëndë për vepër penale – Vjedhja grabitqare – **neni 238**;
- 2 lëndë për vepër penale – Dëmtim i sendeve të huaja – **neni 243**;
- 1 lëndë për vepër penale – Dëmtimi i drejtave të huaja – **neni 244**;
- 5 lëndë për vepër penale – Ndërtimi i paligjshëm – **neni 244-a**;
- 20 lëndë për vepër penale Mashtrimi – **neni 247**;
- 1 lëndë për vepër penale - Dëmtimi dhe hyrja e paautorizuar në sistemin kompjuterik – **neni 251**;
- 5 lëndë për vepër penale – Shtrengimi (detyrimi seksual) – **neni 258**;
- 2 lëndë për vepër penale – Shantazhi – **neni 259**;
- 1 lëndë për vepër penale – Fajdexhillëk – **neni 260**;
- Kreu XXV të KP – Vepra penale kundër financave publike, qarkullim pagesor dhe ekonomik**
- 1 lëndë për vepër penale – Falsifikimi i parave – **neni 268**;
- 1 lëndë për vepër penale – Larja e parave dhe dobia tjetër e kundërligjshme e pasurisë – **neni 273**;
- 1 lëndë për vepër penale - Përpunimi dhe përdorimi i kartelës së rrejshme pagesore – **neni 274- b**;
- 2 lëndë për vepër penale – Kontrabanda – **neni 278**;
- 3 lëndë për vepër penale – Fshehja e tatimit – **neni 279**;
- 2 lëndë për vepër penale – Falsifikimi ose shkatërrimi i librave afariste – neni **280**
- Kreu XXVI të KP – Vepra penale kundër sigurisë së përgjithshme të njeriut dhe pronës**
- 6 lëndë të vepër penale – Vepra të rënda kundër sigurisë së përgjithshme – **neni 292**
- Kreu XXVII të KP – Vepra penale kundër sigurisë në komunikacionin publik**
- 1 lëndë për vepër penale – Rrezikimi i sigurisë në trafik – **neni 297**;
- 29 lëndë për vepër penale Vepra të rënda kundër sigurisë së njerëzve dhe pasurisë në trafik – neni **300**;
- 1 lëndë për vepër penale – Mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësi trafiku – **neni 301**;
- Kreu XXVIII të KP – Vepra penale kundër shtetit**
- 3 lëndë për vepër penale – Kërcënimi terrorist i rendit kushtetues dhe sigurisë – **neni 313**;

1 lëndë për vepër penale – Pjesëmarrje në ushtri të huaj, polici, formacione paraushtarake apo policore – **neni 322-a**;

Kreu XXX të KP – Vepra penale kundër detyrës zyrtare

24 lëndë për vepra penale – Keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar – **neni 353**;

9 lëndë për vepër penale – Të punuarit e pandërgjegjshëm gjatë detyrës – **neni 353 – c**;

1 lëndë për vepër penale – Shpërdorimi i shërbimit – **neni 354**;

8 lëndë për vepër penale – Marrja e rryshfetit – **neni 357**;

Kreu XXXI të KP Vepra penale kundër drejtësisë

1 lëndë për vepër penale – Kallëzimi i rrejshëm i veprës penale – **neni 366**;

1 lëndë për vepër penale – Parashtrimi i provave të rrejshme – **neni 366-a**;

1 lëndë për vepër penale – Dhënia e dëshmisë së rrejshme – **neni – 367**;

2 lëndë për vepër penale – Lirimi kundërligjor i personit të privuar nga liria – **neni 373**;

Kreu XXXII të KP – Veprat penale kundër qarkullimit juridik

5 lëndë për vepër penale – Falsifikimi i dokumenteve – **neni 378**;

Kreu XXXIII të KP – Veprat penale kundër rendit publik

2 lëndë për vepër penale – Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e veprimit zyrtar – **neni 382**;

13 lëndë për vepër penale – Dhuna – **neni 386**;

12 lëndë për vepër penale – Bashkimi kriminel – **neni 394**;

16 lëndë për vepër penale – Përpunimi, mbajtja dhe tregtia e palejuar e armës apo materieve shpërthyesë – **neni 396**;

Kreu XXXIV të KP - Veprat penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare

1 lëndë për vepër penale – Krimet e luftës kundër popullatës civile - **neni 404**;

3 lëndë për vepër penale – Kontrabandë me emigrantë – **neni 418 – b**;

8 lëndë për vepër penale – Organizimi i grupit dhe nxitje për kryerje të veprave tregti me njerëz, tregti me person të mitur dhe kontrabandë me emigrantë – **neni 418 – c**

1 lëndë për vepër penale – Keqpërdorimi i regjimit pa viza në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe të Marrëveshjes së Shengenit – **neni 418 – d**;

1 lëndë për vepër penale – Tregtia me person – **neni 418 – g**;

Struktura e lëndëve të kryera sipas llojit të kundërvajtjes, të evidentuar në regjistër –

KR është siç vijon: 21 lëndë për kundërvajtje ZBSP, 8 lëndë për kundërvajtje të Ligjit për rendin dhe qetësinë publike, 2 lëndë për kundërvajtje nga Ligji për pyjet, 2 lëndë për kundërvajtje nga Ligji për automjetet dhe nga 1 lëndë për kundërvajtje nga Ligji për mbrojtjen e konsumatorëve, nga Ligji për barna dhe mjete ndihmëse mjekësore, nga Ligji për inspeksionin administrativ, nga Ligji për inspektoratin shtetëror të bujqësisë, nga Ligji për pagesa me para në dorë, nga Ligji për lojëra të fatit dhe lojëra argëtuese, nga Ligji për furnizimin dhe mbajtjen e armës dhe municionit, nga Ligji për parandalimin e dhunës dhe nga Ligji për mbrojtjen e bimëve.

Nga gjithsej numri i 223 lëndëve për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit të plotfuqishëm, sipas numrit të lëndëve gjendja është siç vijon:

Tabela 2

	Me 1 person	Me 2 persona	Me 3 persona	Me 4 persona	Me 5 persona	Me 7 persona	Me 11 persona	GJITHSEJ
KVP1	38	6	-	-	-	-	-	44
KVP2	141	16	4	1	-	-	-	162
KVP-KOK1	-	2	-	-	-	-	-	2
KVP-KOK2	7	1	2	-	3	1	1	15
Gjithsej	186	25	6	1	3	1	1	223

Nga gjithsej numri i 223 lëndëve për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit të plotfuqishëm – KVP1, KVP2, Kvp.KOK1 dhe Kvp.KOK2 sipas gjykatave të apelit dhe sipas vendimit të këshillit, gjendja është shfaqur në tabelën 3.

Tabela 3

Gjykatat	KVP1,KVP2		KVP-KOK1		KVP-KOK2	
	të kryera	Të pakryera	Të kryera	Të pa kryera	Të kryera	Të pakryera
Gjykata e apelit Shkup	76	50	2	-	15	11
Gjykata e apelit Manastir	41	13	-	-	-	-
Gjykata e apelit Shtip	35	17	-	-	-	-
Gjykata e apelit Gostivar	54	16	-	-	-	-
GJITHSEJ	206	96	2	-	15	11
			2		26	

Tregues për kërkesa të refuzuara, të aprovuara, të ndryshuara dhe të hedhura poshtë sipas të gjitha bazave

Gjendja e lëndëve sipas të gjitha bazave me të cilat kanë vepruar gjyqtarët në Sektorin e veprave penale, është shfaqur në tabelën nr. 4.

Tabela 4

Lloji i lëndës	Të refuzuara	Të aprovuara	Në tjetër mënyrë	Të hedhura poshtë	të kryera	Të pakryera
VKZH1	49	12	-	6	67	-
VKZH2	27	21	-	10	58	23
KVP1	34	3	-	7	44	-
KVP2	103	15	-	44	162	96
VUK	42	7	2	2	53	8
KZZ	12	24	-	-	36	10
KR	13	26	15	5	59	6
Kvp.KOK1.Kvp	2	-	-	-	2	-
Kvp.KOK2.Kvp	11	2	-	2	15	11
GJITHSEJ	293	110	17	76	496	154

Gjendja e lëndëve sipas kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë – KZZ të parashtruara nga ana e Prokurorisë publike të Republikës së Maqedonisë, që kanë qenë në procedurë në Sektorin e veprave penale dhe që kanë të bëjnë me gjykatat themelore dhe të apelit është siç është shfaqur në tabelën nr. 5.

Tabela 5 Viti 2019 KZZ – pasqyra e lëndëve të kryera sipas gjykatave

Gjykata e apelit	Gjykata themelore dhe numri i lëndëve	Kërkesë e refuzuar	TË APROVUARA							Të kryera	Të pakryera
			I abroguar aktgjykimi i sh. së I	I abroguar aktgjykimi i sh. së II	I abroguar aktgjykimi i sh. së I dhe të sh. së II	Cenimi i KP	Aktgjykimet me lirim	Të hedhura poshtë	Të ndryshuara, ose në tjetër mënyrë		
Shkup 15 lëndë	Gjykata themelore Shkup I – 10 Gjykata themelore Kumanovë – 1 Gjykata themelore Negotinë – 1 Gjykata themelore Veles-2 Gjykata themelore Kavadar- 1	3	-	1	-	4	-	-	1	9	6
Manastir 8 lëndë	Gjykata themelore Strugë-4 Gjykata themelore Manastir-4	2	-	1	1	3	-	-	-	7	1
Shtip 16 lëndë	Gjykata themelore Strumicë-5 Gjykata themelore Koçan-2 Gjykata themelore Radovish- 1 Gjykata themelore S.Nikolë-2 Gjykata themelore Shtip – 3 Gjykata themelore Vinicë – 2 Gjykata themelore Berovë- 1	5	1	1	4	3	-	-	-	14	2
Gostivar 7 lëndë	Gjykata themelore Tetovë – 2 Gjykata themelore Gostivar – 4 Gjykata themelore Kërçovë – 1	2	1	-	-	2	-	-	1	6	1
Gjithsej lëndë në punë: 46 Gjithsej lëndë të kryera: 36		12	2	3	5	12	-	-	2	36	10
1 person	2 persona	3 persona	4 persona	Gjithsej persona të ndëshkuar							
29 lëndë	5 lëndë	-	2 lëndë	36							

Dukshëm nga tabela, nga gjithsej 36 kërkesat e kryera, 12 janë të refuzuara si të pa baza.

Nga të aprovuara: në 2 lëndë aktgjykimi i shkallës së parë abrogohet, në 3 lëndë abrogohet vetëm aktgjykimi i shkallës së dytë, në 5 lëndë abrogohet aktgjykimi i shkallës së parë dhe shkallës së dytë, në 12 lëndë është konstatuar cenimi i KP, në 2 lëndë vendimi është ndryshuar, ndërsa lëndë të pakryera kanë mbetur gjithsej 10.

Sipas rajonit të apeleve gjendja e lëndëve të kryera dhe të pakryera është siç vijon: 15 lëndë nga Gjykata e apelit Shkup, nga të cilat 9 të kryera dhe 6 të pakryera, 8 lëndë nga Gjykata e apelit Manastir, nga të cilat 7 të kryera dhe 1 e pakryer, 16 lëndë nga Gjykata e apelit Shtip, nga të cilat 14 janë të kryera dhe 2 të pakryera dhe 7 lëndë nga Gjykata e apelit Gostivar nga të cilat 6 të kryera dhe 1 e pakryer.

Me një person të ndëshkuar ka pasur 29 lëndë, me dy persona 5 lëndë dhe me katër persona 2 lëndë ose gjithsej 36 persona të ndëshkuar.

Gjendja e lëndëve në procedurë të shkallës së tretë – **VKZH1** për ankesat e aktvendimeve për paraburgim dhe për ankesat e aktgjykimeve të Gjykatave të apelit është shfaqur në **tabelën 6**.

Tabela 6- 1 VKZH1- ankesa nga aktvendimet për paraburgim

Numri i lëndëve të pranuar në vitin 2019	Kanë mbetur nga muaji i 12 të vitit 2018	Gjithsej në punë	të hedhura poshtë	Të refuzuara	Të aprovuara	Në tjetër mënyrë	Të kryera	Të pakryera
67	-	67	6	49	12	-	67	-
Gjithsej: 67	-	67	6	49	12	-	67	-

Tabela 6- 2 VKZH2 – ankesa sipas aktgjykimeve në shkallën e tretë

Numri i lëndëve të pranuar në vitin 2019	Kanë mbetur nga muaji i 12 të vitit 2018	Gjithsej në punë	të hedhura poshtë	Të refuzuara	Të aprovuara	Në tjetër mënyrë	Të kryera	Të pakryera
59	22	81	10	27	21	-	58	23
Gjithsej: 59	22	81	10	27	21	-	58	23

Lëndë të reja pranuar sipas ankesave të aktvendimeve për paraburgim në vitin 2019 janë 67 lëndë, nga të cilat në 49 lëndë ankesa është refuzuar si e pa bazë, në 12 lëndë ankesat aprovohen, ndërsa në 6 lëndë ankesat janë të hedhura poshtë. Lëndë të pakryera nuk ka.

Sipas ankesave të aktgjykimeve të shkallës së tretë – **VKZH2**, në vitin 2019 janë pranuar 59 lëndë, 22 lëndë kanë mbetur nga muaji dhjetor i vitit 2018. ose gjithsej në punë kanë qenë 81 lëndë nga të cilët 27 lëndë janë refuzuar, 21 lëndë janë aprovuar, 10 lëndë janë hedhur poshtë, ndërsa kanë mbetur të pakryera 23 lëndë.

Gjendja e lëndëve për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit - **VUK** është siç vijon:

Nga viti 2018 kanë mbetur të pakryera 17 lëndë, në vitin 2019 janë pranuar 44 lëndë të reja, gjithsej në punë janë 61 lëndë nga të cilat të kryera janë 53 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pakryera 8 lëndë. Sipas llojit të vendimit: 42 lëndë janë të refuzuara, 7 të aprovuara, 2 lëndë janë të hedhura poshtë dhe në tjetër mënyrë janë kryer 2 lëndë.

Gjendja e lëndëve të regjistruara si **KR**, ku Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut sjell vendime për ndeshjen e kompetencave, për bartjen e kompetencës reale dhe vendore, me rastin e parashtresave të parashtruara nga ana e paditësit subsidijar sipas kërkesave të parashtruara për ekstradim, sipas kërkesave të parashtruara për parashkrim, në procedurë kundërvajtës, sipas kërkesave të parashtruara për kthimin në procedurë të mëparshme dhe të tjera është siç vijon:

Nga viti 2018 kanë mbetur të pakryera 12 lëndë, në vitin 2019 janë pranuar 53 lëndë, gjithsej në punë kanë qenë 65 lëndë, nga të cilat 59 lëndë janë të kryera ndërsa kanë mbetur 6 lëndë të pakryera. Sipas llojit të vendimit: në 13 lëndë kërkesat janë të refuzuara, në 26 lëndë janë të aprovuara, në 5 lëndë janë hedhur poshtë dhe në 15 lëndë janë kryer në tjetër mënyrë.

KOHËZGJATJA E PROCEDURËS SIPAS BAZAVE DHE LËNDËVE

Gjatë vitit raportues gjyqtarët kanë kryer **496** lëndë, nga të cilat **1** lëndë të vitit **2014**, **8** lëndë të vitit **2015**, **17** lëndë të vitit **2016**, **63** lëndë të vitit **2017** dhe **122** lëndë të vitit **2018**, ose gjithsej **211** lëndë që kanë mbetur nga vitet e kaluara, ndërsa në fund të vitit kanë mbetur të pakryera **154** lëndë sipas të gjitha bazave. Sipas kësaj, rritja e numrit të lëndëve është tejkaluar plotësisht dhe për pjesën e ngelur është zvogëluar për 71 lëndë.

Kohëzgjatja e procedurës sipas lëndëve në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga pranimi i lëndëve në Sektorin e veprave penale deri në kryerjen dhe ekspedimin e tyre është shfaqur në **tabelën nr. 6**.

Tabela 6 Zgjatja e procedurës për SEKTORIN e veprave penale – viti 2019

Regjistri	Gjithsej në punë	Të kryera	Deri në 1 muaj	Deri në 2 muaj	Deri në 3 muaj	deri në 4 muaj	Deri në 5 muaj	Deri në 6 muaj	Deri në 7 muaj
Regjistri për kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit	61	53	5	17	8	8	3	2	1
Regjistri për kërkesa për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit të plotfuqishëm - 3	44	44							
Regjistri për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit të plotfuqishëm – 5	258	162	8	15	13	16	17	15	12
Regjistri për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit të plotfuqishëm – krimi i organizuar 3	2	2	1						
Regjistri për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit të plotfuqishëm – krimi i organizuar – 5	26	15		2		1			
Regjistri i ankesave të aktvendimit të parburgimit	67	67	67						
Regjistri i ankesave të aktgjykimeve në shkallë të tretë	81	58	3	9	11	8	6	3	4
Regjistri i lëndëve të ndryshme penale	65	59	24	12	6	7	3		
Regjistri i kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë sipas lëndës penale	46	36		2	2	3	5	2	3
GJITHSEJ	650	496	108	57	40	43	34	22	20

Në vitin 2019 siç rrjedh edhe nga tabela për kohëzgjatjen e procedurës, sipas numrit të ndarë të lëndëve nuk ka qenë e mundshme të veprohet menjëherë për shkak të pengesave administrative, që është dashur të tejkalohen (sigurimi i shkresave, mungesa e shkresave origjinale, rregullimi i dorëzimeve të aktgjykimeve të shkallës së dytë drejtuar të akuzuarit, provat e dërguara në fotokopje e të ngjashme).

Te lëndët në të cilat gjykata ka vepruar në shkallën e tretë VKZH, procedura ka zgjatur më shumë në fazën e studimit të lëndës, por është nevojitur kohë edhe për caktimin e mbajtjes së seancave të këshillit.

Disa nga lëndët kanë arritur edhe me shkresa të pa kompletuara, dhe është nevojitur të kthehen në mënyrë administrative në gjykatat, ose në Prokurorinë publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ose janë bërë tentime që atë ta bëjë gjyqtari të cilit i është shpërndarë lënda, me korrespondencë me organin nga i cili është pranuar lënda.

SEKTORI I VEPRAVE CIVILE

Vëllimi i punës

Nga treguesit numëror për vitin 2019, në Sektorin e veprave civile ka pasur **gjithsej 2.129** lëndë **në punë**, nga të cilat **944 lëndë të pakryera** që kanë mbetur nga viti 2018 dhe 2017, ndërsa **lëndë të reja të pranuar** janë **1.185**. Në krahasim me vitin 2018 kur janë pranuar **1.204** lëndë, rritja e lëndëve të reja në vitin 2019 është zvogëluar për **19** lëndë. Në vitin raportues janë kryer **1.211** lëndë, ndërsa lëndë të pakryera kanë mbetur **918**. Krahasuar me vitin 2018 kur janë kryer **1.341** lëndë, në vitin raportues janë kryer **130** lëndë më pak. Krahasuar me vitin 2018, kur kanë mbetur **946** lëndë të pakryera, numri i lëndëve të pakryera në fund të vitit 2019 kap shumën **918**, dhe është zvogëluar për **28** lëndë. Në vitin 2019 në Sektorin e veprave civile rritja e numrit të lëndëve të reja është tejkaluar, respektivisht në vitin 2019 janë pranuar gjithsej **1.185** lëndë ndërsa janë kryer gjithsej **1.211** lëndë, me ç' rast numri i lëndëve të pakryera është zvogëluar për **26** lëndë.

Tabela 1 Tabela e lëvizjes së lëndëve – viti 2019

Regjistri	Të pakryera nga periudha e kaluar	Të reja të pranuar	Të dorëzuara gjyqtari tjetër	Të pranuar nga gjyqtar tjetër	Gjithsej në punë	Të kryera	Të pakryera në fund të periudhës
Regjistri i lëndëve civile sipas revizionit	638	527	423	423	1165	682	483
Regjistri i kontesteve të punës sipas revizionit	125	187	65	65	312	118	194
Regjistri i lëndëve të ndryshme civile	15	225	7	7	240	225	15
Regjistri i kontesteve tregtare sipas revizionit	166	246	80	80	412	186	226
GJITHSEJ	944	1185	575	575	2129	1211	918

Struktura e **1211** lëndëve të kryera është siç vijon: Nga Regjistri Rev1 – të kryera janë 186 lëndë; nga Regjistri Rev2 - janë kryer 682 lëndë; nga Rev3 – janë kryer 118; nga Regjistri R - janë kryer 225 lëndë.

Tabela 2

Lëndë të kryera sipas muajve – viti 2019

Regjistri	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Gjithsej
Regjistri i lëndëve civile sipas revizionit	44	61	73	73	85	24	20	31	59	65	77	70	682
Regjistri i kontesteve tregtare sipas revizionit	13	21	13	24	20	17	15	1	19	24	10	9	186
Regjistri i lëndëve të ndryshme civile	13	9	33	45	16	4	2	7	27	24	17	28	225
Regjistri i kontesteve të punës sipas revizionit	5	11	9	21	13	12	4	3	16	5	8	11	118
GJITHSEJ	75	102	128	163	134	57	41	42	121	118	112	118	1211

Struktura e **918** lëndëve të pakryera është siç vijon: 4 lëndë kanë mbetur të pakryera nga viti 2017 dhe janë nga Regjistri Rev2, nga viti 2018 kanë mbetur të pakryera 160 lëndë edhe atë nga Regjistri Rev1 – 40 lëndë, nga Regjistri Rev2 – 93 lëndë dhe nga Regjistri Rev3 – 27 lëndë. 754 lëndë të pakryera janë të vitit 2019.

Tabela 3 Lëndë të pakryera – viti 2019 (sipas vitit të pranimit)

Regjistri	Të pranuar në vitin 2017	Të pranuar në vitin 2018	Të pranuar në vitin 2019	Gjithsej
Regjistri i lëndëve civile sipas revizionit	4	93	386	483
Regjistri i kontesteve tregtare sipas revizionit		40	186	226
Regjistri i lëndëve të ndryshme civile			15	15
Regjistri i kontesteve të punës sipas revizionit		27	167	194
GJITHSEJ	4	160	754	918

Rezultatet e arritura i nënshtrohen angazhimit të madh për kryerjen e numrit të madh të lëndëve edhe krahas asaj që në Sektorin e veprave civile numri i gjyqtarëve referues ishte zvogëluar në krahasim me vitin e kaluar 2018, të gjithë gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional gjyqësor kanë punuar lëndë edhe të materieve tjera.

Krahasuar me vitet e kaluara, mund të konstatohet se është zvogëluar vëllimi i punës, si rezultat i zvogëlimit gradual të numrit të lëndëve të reja të pranuar, ashtu që në vitin 2014 janë pranuar 1.692 lëndë, në vitin 2015 janë pranuar 1.451 lëndë, në vitin 2016 janë pranuar 1.270 lëndë, në vitin 2017 janë pranuar 1.225 lëndë, në vitin 2018 janë pranuar 1204 lëndë dhe në vitin raportues janë pranuar 1.185 lëndë. Mund të konstatohet edhe ulje e lëndëve të kryera, që është rezultat i numrit të gjyqtarëve që kanë punuar më këtë lloj të lëndëve. Nga analiza e periudhës së kaluar pesëvjeçare mund të konstatohet se në vitin raportues është i ulët numri i lëndëve që kanë mbetur të pakryera dhe i njëjti numëron 918 lëndë.

MËNYRA E LËNDËVE TË KRYERA

Procedura sipas revizionit

Revizioni, si mjet i jashtëzakonshëm juridik, shfrytëzohet nga palët për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre. Nga gjithsej numri i lëndëve civile **2.129** që kanë qenë në punë në vitin 2019, **sipas revizionit janë 1.889** lëndë, nga të cilët nga Regjistri Rev1 – **412** lëndë, nga Regjistri Rev2 – **1.165** lëndë, nga Regjistri Rev3 – **312** lëndë, respektivisht sipas revizioneve ka pasur **88,73%** i gjithsej numri të lëndëve, por nga këto, **të kryera sipas revizionit janë 986** lëndë, respektivisht **52,19%**.

Nga **986** lëndët e kryera, përmbajtja e vendimeve sipas revizioneve duket kështu: të **refuzuara 555** respektivisht **56,30%**, vendime të **ndryshuara** në **85** lëndë respektivisht **8,70%**, vendime të **abroguara** në **111** lëndë respektivisht **11,30 %**, te hedhura poshtë **234** respektivisht **23,70%**.

Sipas numrit të revizioneve të refuzuara, krahasuar me vitet e kaluara, të dhënat duken kështu: në vitin 2014 - 58,30%, në vitin 2015 - 58,17%, në vitin 2016 - 50,8%, në vitin 2017 - 58,84, në vitin 2018 - 62,37% dhe në vitin 2019 - 56,30%. Nga këto numra duket se përqindja e revizioneve që janë të refuzuara si të pabaza në vitin 2019, krahasuar me vitin e kaluar, jo kryesisht është ulur.

Gjendja në gjykatat e apelit sa i përket **revizioneve të refuzuara** në vitin 2019, duket kështu:

- ▲ Gjykata e apelit Shkup, nga gjithsej **585** lëndë të kryera sipas revizioneve, **346** revizione janë refuzuara si të pabaza apo **59,20%**;
- Gjykata e apelit Manastir, nga gjithsej **200** lëndë, **114** revizione kanë qenë të refuzuara si të pabaza apo **57%**;
- Gjykata e apelit Shtip, nga gjithsej **90** lëndë, **43** revizione të refuzuara si të pabaza apo **47,78%**;
- Gjykata e apelit Gostivar, nga gjithsej **107** lëndë, **52** revizione janë të refuzuara si të pabazë apo **48,60%**;

Ndryshimi i vendimeve të goditura ndodh kur gjendja faktike është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, ndërsa në mënyrë të gabuar është zbatuar e drejta materiale. Nëse krahasohen numrat e viteve të fundit, gjendja është siç vijon: në vitin 2014 – 117 apo 6,47%, në vitin 2015 – 108

apo 7,5%, në vitin 2016 të ndryshuara janë 72 vendime apo 6,90%, në vitin 2017 – 82 respektivisht 6,74%, në vitin 2018 – 83 respektivisht 6,99% dhe në vitin 2019 të ndryshuara janë 85 vendime respektivisht 8,62%. Këto numra tregojnë se ndryshimi i vendimeve gjyqësore në vitin e fundit është rritur kryesisht krahasuar me vitin e kaluar raportues, respektivisht nuk ka ndryshime të dukshme në rezultatet e gjykatave të apelit që ka të bëjë me këtë pjesë të punës krahasuar me vitin e kaluar.

Gjendja në gjykatat e apelit sa i përket **revizioneve të aprovuara me vendime të ndryshuara** në vitin 2019, është siç vijon:

- Gjykata e apelit Shkup, nga gjithsej **585** lëndët e kryera sipas revizioneve, vendimet janë ndryshuar në **56** lëndë apo **9,60%**;
- Gjykata e apelit Manastir, nga gjithsej **200** lëndët e kryera sipas revizioneve, vendimet janë ndryshuar në **16** lëndë apo **8%**;
- ▲ Gjykata e apelit Shtip, nga gjithsej 90 lëndët e kryera sipas revizioneve, janë ndryshuar vendimet në 7 lëndë apo 7,78% dhe
- Gjykata e apelit Gostivar, nga gjithsej 107 lëndët e kryera sipas revizioneve, janë ndryshuar vendimet në 6 lëndë apo 5,61 %.

Gjendja në gjykatat e apelit sa i përket **revizioneve të aprovuara me vendime të abroguara** në vitin 2019 duket kështu:

- Gjykata e apelit Shkup, nga gjithsej **585** lëndë, **63** janë të abroguara apo **10,80%**;
- Gjykata e apelit Manastir, nga gjithsej **200** lëndë, **24** janë të abroguara apo **12%**;
- Gjykata e apelit Shtip, nga gjithsej **90** lëndë, **12** janë të abroguara apo **13,33%** dhe
- ▲ Gjykata e apelit Gostivar, nga gjithsej **107** lëndë, **12** janë të abroguara apo **11,21%**.

Gjendja në gjykatat e apelit sa i përket **revizioneve të hedhura poshtë** në vitin 2019, është siç vijon:

- Gjykata e apelit Shkup, nga gjithsej **585** lëndë, **119** janë të hedhura poshtë apo **20,40%**
- Gjykata e apelit Manastir, nga gjithsej **200** lëndë, **46** janë të hedhura poshtë apo **23%**;
- Gjykata e apelit Shtip, nga gjithsej **90** lëndë, **28** janë të hedhura poshtë apo **31,11%**;
- Gjykata e apelit Gostivar, nga gjithsej **107** lëndë, **37** janë të hedhura poshtë apo **34,58%** dhe
- Gjykata administrative 4 lëndë janë të hedhura poshtë;

Tabela 4 Pasqyra e lëndëve të kryera sipas gjykatave dhe vendimeve – revizione 2019

Apeli	Gjykata	Gjithsej të kryera	Të hedhura poshtë	Të refuzuara	Të ndryshuara	Të abroguara	Në tjetër mënyrë
Manastir	Gjykata themelore Krushevë	1	1				
	Gjykata themelore Resnjë	1	1				
	Gjykata themelore Ohër	72	12	46	4	10	
	Gjykata themelore Strugë	23	4	16	1	2	
	Gjykata themelore Manastir me seksion në Demir Hisar	66	18	30	9	9	
	Gjykata themelore Prilep	37	10	22	2	3	
	Gjithsej në rajonin e apelit	200	46	114	16	24	
Gostivar	Gjykata themelore Dibër	5		5			
	Gjykata themelore Tetovë	42	18	15	3	6	

	Gjykata themelore Kërçovë me seksion në Makedonski Brod	27	10	15	1	1	
	Gjykata themelore Gostivar	33	9	17	2	5	
	Gjithsej në rajonin e apelit	107	37	52	6	12	
Shkup	Gjykata themelore Kratovë						
	Gjykata themelore Kumanovë	42	11	23	4	4	
	Gjykata themelore Kavadar	9	4	3	1	1	
	Gjykata themelore civile Shkup	483	95	289	44	54	1
	Gjykata themelore Veles	34	6	18	6	4	
	Gjykata themelore Negotinë	3	1	2			
	Gjykata themelore Kriva Pallankë	4	1	3			
	Gjykata themelore Gjevgjeli me seksion në Vallandovë	10	1	8	1		
	Gjithsej në rajonin e apelit	585	119	346	56	63	1
Shtip	Gjykata themelore Radovish	6	4	1	1		
	Gjykata themelore Vinicë	1		1			
	Gjykata themelore Strumicë	24	7	11	1	5	
	Gjykata themelore Sveti Nikollë	5	2	3			
	Gjykata themelore Shtip me seksion në Probishtip	28	12	11	2	3	
	Gjykata themelore Koçan	15	2	10	2	1	
	Gjykata themelore Berovë	2	1			1	
	Gjykata themelore Dellçevë	9		6	1	2	
	Gjithsej në rajonin e apelit	90	28	43	7	12	0
	Gjykata administrative	4	4				
	GJITHSEJ	986	234	555	85	111	1

PROCEDURA QË KANË MBETUR

Sektori i veprave civile përveç mjeteve të jashtëzakonshme juridike, vendos edhe për lëndë tjera nga kompetenca e tij. Ato janë lëndë për ndeshje të kompetencave, përcaktim i gjykatës reale kompetente, vazhdimin e afatit për parashtrimin e padisë për kontestimin e atësisë, nga të cilët kanë qenë në punë gjithsej **240** lëndë dhe nga këto të kryera janë **225** lëndë, apo **93,75%**, ndërsa kanë mbetur të pakryera 15 lëndë apo **6,25%**.

Struktura e lëndëve

Dukshëm nga bazat juridike të revizioneve për të cilat është marrë vendim në Sektorin e veprave civile gjatë vitit 2019, mund të konstatohet ndryshueshmëri. Të shumta janë lëndët sipas bazës për **kompensim të dëmit – 279** lëndë apo **28,30%**, pastaj sipas bazës **borxhi – 229** lëndë apo **23,23%**; për **pronësi dhe zotërim – 189** lëndë apo **19,17%**; **konteste pune – 109** lëndë apo **11,05%**; **shfuqizim dhe ndërprerje e marrëveshjes – 50** lëndë apo **5,07%**; për **asistencë – 38** lëndë apo **3,85%**; për **arritje pa bazë – 36** lëndë apo **3,65%**; për **falimentim – 34** lëndë apo **3,45%**, **konteste tjera – 15** lëndë apo **1,53%** dhe **të drejta autorësie dhe pronësi industriale – 7** lëndë apo **0,70%**.

Tabela 5 Struktura e lëndëve të kryera për vitin 2019

Baza	2018	2019
Asistenca	40	38
Kompensim i dëmit	315	279
Arrija pa bazë	41	36
Shfuqizimi dhe ndërprerja e marrëveshjes	80	50
Borxhi	273	229
Pronësia dhe zotërimi	118	189
Kontest pune	194	109
Falimentim të drejtat e autorit dhe pronësia ind.	86 3	34 7
Konteste tjera	38	15
Gjithsej	1188	986

Krahasuar me vitin e kaluar, në vitin 2019 ka dallim në numrin e revizioneve për të cilat është marrë vendim sipas bazave në vijim: Është zvogëluar numri i lëndëve të kryera krahasuar me vitin 2018 sipas bazave në vijim: kompensim i dëmit – në vitin 2019 janë kryer 279 lëndë ndërsa në vitin 2018 janë kryer 315 lëndë; për borxh – në vitin 2019 janë kryer 229 lëndë ndërsa në vitin 2018 janë kryer 273 lëndë, kontest pune – në vitin 2019 janë kryer 109 lëndë ndërsa në vitin 2018 – 194 lëndë; shfuqizimi dhe ndërprerja e marrëveshjes – në vitin 2019 janë kryer 50 ndërsa në vitin 2018 – 80 lëndë; falimentim – në vitin 2019 janë kryer 34 lëndë ndërsa në vitin 2018 – 86 lëndë; konteste tjera – në vitin 2019 janë kryer 15 lëndë ndërsa në vitin 2018 – 38 lëndë. Është rritur numri i lëndëve të kryera krahasuar me vitin e kaluar sipas bazës të drejtat e autorit, respektivisht në vitin 2019 të kryera janë 7 lëndë ndërsa në vitin 2018 të kryera janë 3 lëndë dhe për pronësia dhe zotërimi, në vitin 2019 të kryera janë 189 lëndë, përderisa në vitin 2018 të kryera janë 118 lëndë. Sipas bazave të tjera – asistenca, arrija pa bazë, nuk është vërejtur dallim shumë i madh në numrin e revizioneve për të cilat janë marrë vendime në vitin raportues krahasuar me vitin e kaluar 2018.

Zgjatja e procedurës

Në vitin 2019 nga gjithsej 1.211 lëndëve të kryera, zgjatja e procedurës mbi tri vjet ka pasur te 1 lëndë; nga 1 deri 3 vjet te 414 lëndë; nga 8 muaj deri 1 vjet në 324 lëndë; nga 6 deri 8 muaj në 145 lëndë; nga 3 deri 6 muaj në 90 lëndë; nga 2 deri 3 muaj në 36 lëndë, nga 1 deri 2 muaj në 112 lëndë, deri në 1 muaj ka zgjatur procedura në 89 lëndë. Duket se, për një pjesë të konsiderueshme e lëndëve në këtë gjykatë edhe më tej zgjat relativisht gjatë kohë, edhe pse pakontestueshëm ai trend krahasuar me vitet e kaluara shkon drejt përmirësimit. Gjendja e këtillë është rezultat i vëllimit relativisht të madh të punës, zvogëlimi i numrit të gjyqtarëve në Sektorin e veprave civile për shkak të mos plotësimit të vendeve të punës së gjyqtarit, për shkak të zbrazjes së vendeve për shkak të pensionimit dhe sistemin e gjyqtarëve të punojnë në sektorët tjerë.

Tabela 6 Zgjatja e procedurës në vitin 2019

Regjistri	Gjithsej në punë	Të kryera	Deri në 1 muaj	Prej 1 deri 2 muaj	Prej 1 deri 3 muaj	Prej 3 deri 6 muaj	Prej 6 deri 8 muaj	Prej 8 muaj deri 1 vjet	Prej 1 deri 3 vjet	Mbi 3 vjet	Kanë mbetur për punë	Të pranuar
Regjistri i veprave civile sipas revizionit	1165	682	1	8	2	26	66	267	312		483	527
Regjistri i kontesteve të punës sipas revizionit	312	118				11	35	26	45	1	194	187
Regjistri i lëndëve të ndryshme civile	240	225	85	87	27	23	3				15	225
Regjistri i kontesteve tregtare sipas revizionit	412	186	3	17	7	30	41	31	57		226	246
GJITHSEJ	2129	1211	89	112	36	90	145	324	414	1	918	1185

SEKTORI PËR GJYKIM NË AFAT TË ARSYESHËM

Në pajtim me Ligjin për gjykatat, Rregulloren e punës së Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Orarin e punës së gjyqtarëve dhe të administratës gjyqësore për vitin 2019, gjyqtarët e **Sektorit për gjykim në afat të arsyeshëm** gjatë vitit 2019 kanë vepruar sipas lëndëve të formuara sipas kërkesave të parashtruara për mbrojtjen e të drejtës së gjykimit në afat të arsyeshëm dhe ankesave kundër aktvendimeve të këshillit prej tre gjyqtarëve sipas kërkesave për mbrojtjen e të drejtës së gjykimit në afat të arsyeshëm.

Krahas punës me lëndë konkrete, gjyqtarët kanë marrë pjesë edhe në mbledhje të Sektorit për gjykim të arsyeshëm, ku janë shqyrtuar çështje aktuale dhe janë marrë konkluzione për çështje juridike që janë me kuptim të veprimit të këshillave dhe unifikimin e praktikës së Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut me praktikën e Gjykatës për të drejtat e njeriut në Strasburg. Krahas saj, kanë marrë pjesë në punën e Mbledhjes së përgjithshme dhe në mbledhjet e gjyqtarëve të Gjykatës supreme, si dhe në shumë aktivitete tjera me qëllim për zbatimin më të mirë dhe më efikas të Kushtetutës, ligjeve dhe marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare me Kushtetutën, aktgjykimet e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut në Strasburg, si dhe në aktivitete nën lëndorë, me qëllim të përmirësimit të rolit të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Vëllimi i punës të këtij SEKTORI

Gjatë vitit 2019, Sektori i gjykimit në afat të arsyeshëm në punë ka pasur gjithsej 606 lëndë (në të dyja shkallët e vendimmarrjes), nga të cilët:

459 lëndë në shkallë të parë ose 75,74% dhe

147 lëndë në shkallë të dytë ose 24,26%.

Nga gjithsej numri i 606 lëndëve në punë në këtë Sektor, gjatë vitit 2019, gjithsej të kryera janë 429 lëndë ose 70,79 % nga të cilat

313 lëndë në shkallë të parë ose 72,96 % dhe

116 lëndë në shkallë të dytë ose 27,04 %

Nga gjithsej 606 lëndë në punë në këtë Sektor, të pakryera nga periudha e kaluar të vitit raportues (në të dyja shkallët e vendimmarrjes) kanë mbetur 235 lëndë ose 38,78%, nga të cilat:

218 lëndë në shkallën e parë ose 92,77 % dhe

17 lëndë në shkallë të dytë ose 7,23 %.

Të pranuar janë gjithsej 371 lëndë ose 61,22 % nga të cilat:

241 lëndë në shkallë të parë ose 64,96 % dhe

130 lëndë në shkallë të dytë ose 35,04 %.

Nga gjithsej 429 lëndët e kryera në këtë Sektor në vitin 2019:

I. Në gjithsej 203 lëndë ose 47,32 % - kërkesa për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, refuzohet si e pa bazë, nga të cilat:

112 lëndë në shkallë të parë ose 55,17 % dhe

91 lëndë në shkallë të dytë ose 44,83 %.

II. Në gjithsej 165 lëndë ose 38,46 % - kërkesa për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, është miratuar, nga të cilat:

140 lëndë në shkallën e parë ose 84,85% dhe

25 lëndë në shkallën e dytë ose 15,15 %.

III. Në gjithsej 61 lëndë ose 14,22 %, kërkesa për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, hedhet poshtë, nga të cilat:

61 lëndë në shkallën e parë ose 100 %

IV. Gjithsej 177 lëndë ose 29.20 %, nga gjithsej numri 606 i lëndëve në punë kanë mbetur të pakryera, nga të cilat:

146 lëndë në shkallën e parë ose 82,49 % dhe

31 lëndë në shkallën e dytë ose 17.51 %.

Tabela 1

Gjykim në afat të arsyeshëm – të shkallës së dytë						
Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuara gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
17	130	0	0	147	116	31
17	130	0	0	147	116	31
Gjykim në afat të arsyeshëm - të shkallës së parë						
Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuara gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
72	69	0	0	141	73	68
65	62	1	0	128	83	45
81	109	0	0	190	157	33
218	240	1	0	459	313	146
235	370	1	0	606	429	177

Vëllimi i punës së KËSHILLIT TË SHKALLËS SË PARË

Në vitin **2019**, në këshillin e shkallës së parë, gjithsej në punë ka pasur **459** lëndë ose **75,74 %**, nga gjithsej **606 lëndë në këtë Sektor, nga të cilët:**

Nga gjithsej **459** lëndë në punë në këshillin e shkallës së parë, **218 lëndë ose 47,49 % janë lëndë të pakryera nga viti 2018**, nga të cilat:

81 lëndë nga materia civile ose **37,15%**,
72 lëndë nga materia administrative ose **33,03**,
65 lëndë nga materia penale ose **29,82%**.

Nga gjithsej **459** lëndë në punë në këshillin e shkallës së parë, **të pranuar** janë gjithsej **241** lëndë ose **52,51 %**, nga të cilët:

109 lëndë nga materia civile ose **45,23%**;
69 lëndë nga materia administrative ose **28,63%**,
63 lëndë nga materia penale ose **26,14%**.

Në vitin **2019** nga gjithsej numri i **459** lëndëve, në punë në këshillin e shkallës së parë :

190 lëndë janë nga materia civile ose **41,40%**,
128 lëndë janë nga materia penale ose **27,89 %**,
141 lëndë janë nga materia administrative ose **30,71%**.

Në vitin **2019**, **gjithsej** të kryera janë **313** lëndë nga të cilat:

157 lëndë janë nga materia civile ose **50,16%**,
73 lëndë janë nga materia administrative ose **23,32%**,
83 lëndë janë nga materia penale ose **26,52%**.

Në fund të vitit **2019**, **të pakryera janë** gjithsej **146 lëndë** nga të cilat,

33 lëndë janë nga materia civile ose **22,60%**,
68 lëndë janë nga materia administrative ose **46,58%**,
45 lëndë janë nga materia penale ose **30,82%**.

LLOJI DHE MËNYRA E KRYERJES SË LËNDËVE NË KËSHILLIN E SHKALLËS SË PARË

Nga gjithsej **313** lëndët e kryera ose **68,19 %** nga gjithsej **459** lëndët në punë në këshillin e shkallës së parë:

Në **140** lëndë ose **44,73%**, kërkesa për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm është **aprovuar nga të cilët:**

67 lëndë janë nga materia civile ose **47,86 %**,
31 lëndë janë nga materia administrative ose **22.14%**,
42 lëndë janë nga materia penale ose **30%**.

Në **112** lëndë ose **35.78%**, kërkesa për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm **refuzohet si e pabazë, nga të cilët:**

61 lëndë janë nga materia civile ose **54.46%**,
21 lëndë janë nga materia penale ose **18.76%**,
30 lëndë janë nga materia administrative ose **26.78%**.

Në **61** lëndë ose **19.49%**, kërkesa për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm **hidhet poshtë, nga të cilët:**

29 lëndë janë nga materia civile ose **47.54%**,
20 lëndë janë nga materia penale **32.79%**,
12 lëndë janë nga materia administrative **19.67%**.

Analiza e gjithsej numrit të lëndëve të kryera në këshillin e shkallës së parë dhe parametrat e kërkesave të aprovuara, të refuzuara dhe të hedhura poshtë në këtë periudhë raportuese tregojnë se mbisundon numri i lëndëve të kryera me aprovimin e kërkesës për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, veçanërisht në lëndët me materie civile.

Koha e veprimit në KËSHILLIN E SHKALLËN SË PARË

Nga gjithsej **459** lëndët në punë, në shkallën e parë janë kryer **313** lëndë ose **68.19 %** në të cilët kohëzgjatja e veprimit në këshillin e shkallës së parë të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut sipas kërkesave të deklaruara për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, e kaplon periudhën nga pranimi i kërkesës në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, deri në ekspedimin e aktvendimit të shkallës së parë parashtruesit të kërkesës.

Nga gjithsej 313 lëndët e kryera

- në periudhën deri në **1 muaj është kryer 1** lëndë nga materia penale ose **0,31 %** - në periudhën **prej 1 deri 2 muaj** janë kryer gjithsej **17** lëndë ose **5,43 %** nga të cilët:

- 12** lëndë janë nga materia civile
- 3** lëndë janë nga materia administrative
- 2** lëndë janë nga materia penale,

- në periudhën nga **2 deri 3 muaj** janë kryer gjithsej **27** lëndë ose **8,63 %**, nga të cilët:

- 17** lëndë janë nga materia civile
- 2** lëndë janë nga materia administrative
- 8** lëndë janë nga materia penale,

- në periudhën **prej 3 deri 6 muaj**, janë kryer gjithsej **67** lëndë ose **21,41 %**, nga të cilët

- 39** lëndë janë nga materia civile
- 13** lëndë janë nga materia administrative
- 15** lëndë janë nga materia penale.

- në periudhën **prej më shumë se 6 muaj**, janë kryer **201** lëndë ose **64,22 %**, nga të cilët:

- 89** lëndë janë nga materia civile,
- 55** lëndë nga materia administrative,
- 57** lëndë nga materia penale.

- Kanë mbetur për punë në vitin **2019** gjithsej **146** lëndë ose **31.81%** nga të cilët:

- 33** lëndë janë nga materia civile
- 68** lëndë janë nga materia administrative
- 45** lëndë nga materia penale.

Shkaqe për tejkalimin e afatit prej **6 muajve** si kornizë ligjore për kryerjen e këtij lloji të lëndëve në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, dukshëm nga numri i **146** i lëndëve të pakryera, është kryesisht mungesa e shkresave të lëndëve për të cilat ka të bëjë kërkesa. Nga shkak i theksuar rrjedh se vonimi i deklaramit të gjyqtarëve që veprojnë me lëndët, përkatësisht numri i madh i lëndëve të pakryera në këshillin e shkallës së parë edhe krahas urgjencave të shumta të dërguara për dorëzimin e shkresave për kërkesën e dorëzuar gjykatës e cila ka vepruar me lëndën konkrete, për të cilën ka të bëjë kërkesa për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm.

Në këtë kontest, mungon mjet juridik me të cilin Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut do t'ua imponojë gjykatave më të ulëta për dorëzimin më të shpejtë të shkresave të lëndës, veçanërisht në rastet kur lënda për të cilën ka të bëjë kërkesa për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, është lëndë aktive, respektivisht lëndë që është në rrjedhë, ku vlen rregulla që të formohen kushte që procedura e lëndës të vazhdojë në fazën në të cilën ndodhet dhe të mos e presë vendimmarrjen sipas kërkesës për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm. Pamundësia, në të gjitha rastet të respektohet afati prej **6 muajsh** për kryerjen sipas kërkesës për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, vërehet çdo vit të deritanishëm raportues dhe ka qenë lëndë diskutimi edhe në Mbledhjet e Sektorit, ku janë miratuar konkluzione përkatëse, të cilat vet më vete nuk mund të japin rezultat, nëse në mënyrë sistemuese nuk ka qasje edhe në shqyrtimin e rregullave proceduese për këtë lloji të lëndëve, si dhe objektiviteti i kornizës së vënë ligjore që nuk korrespondon me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut. Në fakt me kornizën ligjore prej **6 (gjashtë) muajsh** dhe mos krijimi i kushteve proceduese për shpejtimin e procedurës, gjegjësisht kryerjen e lëndëve në atë afat në të dyja shkallët e vendimmarrjes në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, vet më vete do të thotë dhënia e mundësisë palëve – kërkuësve që të ankohen edhe për zgjatjen e procedurës në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Pamundësia që Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut në

të gjitha rastet që ta respektojë afatin – kornizë prej **6 (muajsh)** për kryerjen e procedurave për kërkesën për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, nënkuptojnë edhe detyrim për shqyrtimin e afatit ligjor në kontest të konsistencës së procedurës në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut dhe praktikën e kësaj gjykate. Në këtë kontest, potencohet detyrimi i kryetarëve të gjykatave, të bëjnë përpjekje për dorëzimin e shkresave të lëndëve për të cilat bëhet vlerësimi i veprimit në afat të arsyeshëm, me qëllim që Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut të mund t'i respektojë afatet për gjykim në afat të arsyeshëm, duke marrë parasysh se pasojat e veprimit jo në kohë për detyrimin e dorëzimit të shkresave të lëndëve që nevojiten për veprimin sipas kërkesave për gjykim në afat të arsyeshëm, reflektohet në veprimin e përgjithshëm sipas këtyre lëndëve në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, e me të edhe vlerësimin për efikasitetin e mjetit juridik. Me anë të kuptimit për ndjekjen e efikasitetit të mjetit juridik është që të insistohet nëpërmjet kryetarëve të gjykatave, që me kohë të jepen të dhënat me qëllim të respektimit të afateve që janë dhënë në këtë gjykatë për kryerjen e lëndëve që janë në rrjedhë, në procesin e fazës së vendimmarrjes për të cilën ka të bëjë kërkesa për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm.

VËLLIMI I PUNËS NË KËSHILLIN E SHKALLËS SË DYTË

Në vitin **2019**, në këshillin ankimor të shkallës së dytë në punë ka pasur gjithsej **147 ose 24,26 %** lëndë, nga gjithsej numri i **606** lëndëve në këtë Sektor, nga të cilët: **17 lëndë ose 11,56% kanë mbetur** të pakryera nga periudha e kaluar raportuese. **130 lëndë ose 88,44% janë lëndë të pranuar** në vitin raportues **2019**.

MËNYRA E VENDIMARRJES SIPAS ANKESAVE TË DEKLARUARA

Nga gjithsej numri i lëndëve në punë (**147**), në vitin 2019 **gjithsej të kryera janë 116 lëndë ose 78,91%** nga të cilët:

në **91 lëndë ose 78,45%** ankesa refuzohet si e pabazë,

në **25 lëndë ose 21,55%** ankesa aprovohet

- nga gjithsej **147 lëndë** në punë, **të pakryera kanë mbetur 31 lëndë ose 21,09%**.

Analiza e gjithsej numrit të lëndëve të kryera në këshillin e shkallës së dytë edhe ato që janë dhënë sipas strukturës, shpjegon tendencën e kryerjes më të shpejtë të lëndëve dhe uljen e numrit të lëndëve që kanë mbetur të pakryera, por parametrat e kërkesave të aprovuara, të refuzuara dhe të hedhura poshtë edhe në këtë periudhë raportuese shpjegojnë se mbisundon numri i lëndëve të kryera me refuzimin e ankesës si të pabazë respektivisht me **konfirmimin e aktvendimit të shkallës së parë** në gjithsej **91 lëndë**.

Koha e veprimit të KËSHILLIT TË SHKALLËS SË DYTË sipas ankesave të deklaruara

Kohëzgjatja e veprimit të këshillit të shkallës së dytë në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, kompetente për vendimmarrjen sipas ankesave të deklaruara kundër aktvendimeve të shkallës së parë, e përfshin periudhën nga pranimi i ankesës në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, deri në ekspedimin e aktvendimit të shkallës së dytë parashtruesit të kërkesës.

Nga gjithsej numri i lëndëve në punë në këshillin ankimor të shkallës së dytë, të kryera janë gjithsej **116 lëndë**,

- për periudhën prej **1 muajsh** procedura është kryer në **39 lëndë ose 33,62%**,

- për periudhën prej **1 deri 2 muajsh** procedura është kryer në **31 lëndë ose 26,72%**,

- për periudhën prej **2 deri 3 muajsh** procedura është kryer në **25 lëndë ose 21,56 %**,

- për periudhën prej **3 deri 6 muajsh** procedura është kryer në **17 lëndë ose 14,65 %**,

- për periudhën prej **mbi 6 muajsh** procedura është kryer në **4 lëndë ose 3,45 %**

Nga gjithsej **116** lëndë në punë, **të pakryera** kanë mbetur **31** lëndë ose **26,72 %**.

Analiza e kohës për kryerjen e lëndëve në këshillin ankimor, shpjegon **respektimin relativ të afatit prej 6 muajsh**, si kornizë ligjore për vendimmarrjen për lëndët edhe në të dyja shkallët e vendimmarrjes në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kjo, veçanërisht që gjatë caktimit të kornizës ligjore prej 6 muajsh nuk është marrë parasysh koha e nevojshme për dorëzimin e lëndëve të kryera në shkallën e parë palëve dhe rrjedhja e afatit për ankesë. Nga këtu, koha për kryerjen e lëndëve në këshillin ankimor marrë vet më vete përcakton se afati për veprimin sipas këtij lloji të lëndës në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, është në përputhje me praktikën e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut.

KOMPENSIMI I DREJTË

Nga gjithsej **429 lëndët e kryera, nga të cilët 313** lëndë në shkallën e parë dhe **116** lëndë në shkallën e dytë në procedurën ankimore, për të cilat është marrë vendim në Sektorin për gjykim në afat të arsyeshëm në vitin **2019, shuma maksimale** që është shqiptuar në emër të kompensimit të drejtë për shkak të cenimit së të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm **në shkallën e parë** është **500.000,00** denarë, ndërsa shuma e shqiptuar **minimale në këshillin e shkallës së parë** është **5.000,00** denarë. Përderisa, shuma **maksimale** që është shqiptuar në emër të kompensimit të drejtë për shkak të cenimit të konstatuar për të drejtën e gjykimit në afat të arsyeshëm **në këshillin e shkallës së dytë kap shumën prej 30.000,00** denarë, ndërsa shuma **minimale** në emër të kompensimit të drejtë kap shumën **5.000** denarë.

Nga gjithsej **429** lëndë të kryera në vitin **2019** në **shkallën e parë** është shqiptuar kompensim i drejtë në gjithsej shumën prej **3.492.000,00** denarë, ndërsa në **shkallën e dytë** shumën prej **314.800,00** denarë ose gjithsej shuma në të dyja shkallët e vendimmarrjes prej **3.806.800,00** denarë, si në emër të kompensimit të drejtë, ashtu edhe për shpenzimet e procedurës sipas kërkesës së parashtruar për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm.

SEKTORI I PRAKTIKËS GJYQËSORE

Spektori i praktikës gjyqësore në vitin 2019, ka punuar për realizimin e qëllimit themelor, për drejtimit dhe prioritetet në unifikimin e zbatimit të ligjit dhe ndjekjen e praktikës gjyqësore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Për realizimin e qëllimit themelor, Spektori në vitin 2019, i ka ndjekur kuptimet e përgjithshme juridike dhe qëndrimet e përgjithshme të rëndësishme për sigurimin e barazisë në zbatimin e ligjit nëpërmjet studimit të praktikës së gjykatave vendore dhe Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut dhe krahasimet – praktikat e gjykatave nga sistemi paraprak juridik i vendeve përreth. Njëkohësisht, ka marrë pjesë në përgatitjen e planit për kuptimet juridike dhe materialet tjera nga mbledhjet e sektorëve gjyqësorë dhe nga Mbledhjet e përgjithshme; ka evidentuar qëndrimet parimore dhe mendimet juridike parimore në Mbledhjet e përgjithshme, mendimet juridike dhe konkluzionet të miratuara në mbledhjen e Sektorit, në mbledhjet e përbashkëta të sektorëve ose në mbledhjet e gjyqtarëve dhe sentencat nga këshillat; ka bërë seleksionimin dhe evidentimin e vendimeve me rëndësi të posaçme (vendime të rëndësishme) në raste për të cilat pritet të jenë me rëndësi të posaçme për praktikën gjyqësore; ka bërë kontrollimin e vendimeve të këshillave për shkak të verifikimit se a është vendimi në përputhje me kuptimin juridik të shprehur në ndonjë vendim paraprak ose vendim në të njëjtën kohë; ka ndjekur, studiuar dhe ka marrë pjesë në harmonizimin e praktikës gjyqësore – unifikimin e zbatimit të ligjeve në nivel të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe gjykatat në Republikën e Maqedonisë së Veriut, nëpërmjet takimeve të përbashkëta me gjykatat e apelit dhe ndjekjen e konsistencës së normave juridike dhe përmirësimin e tyre dhe ka kontribuar në unifikimin e zbatimit të drejtë të gjykatave, sa i përket zbatimit dhe citimit të praktikës së Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut, në vendimet e gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Spektori i praktikës gjyqësore ka vepruar edhe për lëndë të formuara sipas kërkesave nga subjekte të ndryshëm (avokatë, persona juridik, qytetarë) për konstatimin e qëndrimeve parimore dhe mendimeve juridike parimore për çështje që kanë kuptim sigurimin e barazisë në zbatimin e ligjeve nga ana e gjykatave dhe për kërkesat e parashtruara që kanë të bëjnë

me dallimet në zbatimin e ligjit nga ana e gjykatave të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe unifikimin e praktikës gjyqësore.

I. Lidhur me sigurimin e unifikimit horizontal dhe vertikal të praktikës gjyqësore, respektivisht realizimin e qëllimit themelor – sigurimin e barazisë në zbatimin e ligjeve nga ana e gjykatave, Sektori i praktikës gjyqësore gjatë vitit 2019, ka ndjekur kuptimet e përgjithshme juridike dhe qëndrimet e përgjithshme me rëndësi për sigurimin e zbatimit unik të ligjit nëpërmjet studimit të praktikës së gjykatave vendore dhe institucioneve ndërkombëtare.

II. Sektori i praktikës gjyqësore gjatë vitit 2019, në suaza të punës së tij të rregullt, ka marrë pjesë në përgatitjen e planit për mendimet juridike parimore dhe qëndrimet parimore në Mbledhjet e përgjithshme në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, mendimet juridike dhe konkluzionet e sektorëve të specializuar dhe sentencat e pranura të këshillave, si dhe në evidentimin me sistematizimin sipas sferave juridike edhe publikimin në Ueb faqen e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut në pjesën e praktikës gjyqësore.

Në vitin 2019, të miratuara dhe të publikuara në UEB faqen janë 2 (dy) mendime juridike parimore , 4 (katër) mendime juridike dhe konkluzione dhe 9 (nëntë) sentenca:

Tabela 1

Mendime juridike parimore	2	- Afati për ngritjen e akuzës nga ana e PP për ndjekjen e veprave penale dhe që rrjedhin nga përmbajtja e ndjekjes joligjore të komunikimeve - Përgjegjësia e dëmit të shkaktuar shfrytëzuesve të rrugëve shtetërore
Qëndrime parimore	/	
Mendime juridike dhe konkluzione	4	- Shpenzimet e transportit nga dhe deri në punë i të punësuarve në sektorin publik që punojnë jasht vendit ku jetojnë - Përrjashtim i gjyqtarit që ka marrë pjesë si anëtarë i Këshillit penal në procedurën ankimore kundër aktvendimit të këshillit për vlerësimin e aktit akuzues – neni 32 paragrafi 2 të Ligjit për procedurë penale - Vlefshmëria kohore e ligjit – rregull – akt i përgjithshëm i abroguar me vendim të Gjykatës kushtetuese - Shpenzimet për publikimin e aktgjykimit
Sentenca	9	- Parashkruet mëria e kërkesës për kompensimin e dëmit - E drejta e pronësisë dhe të drejta tjera reale - Shqetësimi drejtuar personit fizik - Detyrë e gjykatës të sugjerojë parashtruesin i cili nuk ka prokurues për ta përcaktuar vlerën e kontestit - Ndërprerja e afatit për parashkrim - Parashkrimi i kërkesës për kompensimin e dëmit ndaj likuiduesit të personit juridik - Shkarkimi i drejtorit të institucionit publik - Interesi juridik për konstatimin e autenticitetit respektivisht jo autenticitetit të ndonjë dokumenti - E drejta e regresit në rastin e pamundësisë për konstatimin e prezencës së alkoolit në momentin e aksidentit

III. Në vitin 2019, Sektori i praktikës gjyqësore ka realizuar seleksionimin, evidentimin dhe sistematizimin sipas sferave juridike të vendimeve me rëndësi juridike (vendime kryesore) të këshillave gjyqësorë të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me ç’ rast „Praktika gjyqësore” që paraqet bazë të dhënash interne të disponueshme për të gjithë gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional gjyqësor të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë, është azhurnuar me 140 vendime. Njëkohësisht, nga ana e Sektorit të praktikës gjyqësore janë ndjekur vendime të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë, me qëllim të unifikimit të praktikës

gjqësore është kryer edhe kërkimi i vendimeve të ngjashme apo identike në bazën e të dhënave të cilën e ka Sektori i praktikës gjyqësore, në programin Akmis nëpërmjet shkresoreve dhe të Ueb faqes së Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut ku publikohen vendimet e anonizuara të Gjykatës.

IV. Sektori i praktikës gjyqësore në vitin 2019, ka vepruar sipas 79 lëndëve, të evidentuara nën SPR numër, të cilët janë formuar sipas kërkesave për konstatimin e qëndrimeve parimore dhe mendimeve juridike parimore nga çështje me kuptim për sigurimin e barazisë me zbatimin e ligjeve nga ana e gjykatave, sipas kërkesave të parashtruara që kanë të bëjnë me dallimet në zbatimin e ligjeve nga ana e gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe unifikimin e praktikës gjyqësore, me dorëzimin e shkresave nga gjykatat dhe për shkresat nga Ministria e drejtësisë, Byroja për përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Gjykatën Evropiane për të drejtat e njeriut, ndërsa në lidhje me praktikën gjyqësore dhe lëndët të cilët kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut realizohen në Gjykatën Evropiane për të drejtat e njeriut në Strasburg.

V. Në suaza të punës së vet të rregullt, Sektori i praktikës gjyqësore në vitin 2019 ka mbajtur 7 mbledhje, të regjistruara nën SPZ numër. Në mbledhjet, në mes tjerash është konstatuar mënyra për evidentimin e kërkesave dhe shkresave të cilat arrijnë në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe veprimi i mëtejshëm sipas tyre në Sektorin e praktikës gjyqësore dhe në këtë gjykatë. Është konstatuar edhe mënyra e përgatitjes dhe mbajtja e mbledhjeve, nevoja për vazhdimin e bashkëpunimit të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut me Qendrën për hulumtime dhe analiza me diferencimin e konceptit të punës dhe bashkëpunimin. Janë shqyrtuar 32 lëndë.

VI. Në mbledhjen e Sektorit të praktikës gjyqësore, të mbajtur më 29.03.2019, në drejtim të bashkëpunimit të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut me Qendrën për hulumtime dhe analiza juridike, e njohur nëpërmjet projektit për miratimin e „Udhëzues për citimin e praktikës së Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut nga gjykatat në Republikën e Maqedonisë së Veriut“, është sjellë konkluzion me të cilin është miratuar „Udhëzues për citimin e praktikës së Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut nga gjykatat në Republikën e Maqedonisë së Veriut“.

Udhëzuesi për citimin e praktikës së Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut për gjykatat në Republikën e Maqedonisë së Veriut është publikuar në UEB faqen e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa ekzemplarë të botuar nga i njëjti u janë dorëzuar të gjithë gjyqtarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Për promovimin e Udhëzuesit për citimin e praktikës së Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut për gjykatat në Republikën e Maqedonisë së Veriut, janë organizuar dhe janë mbajtur 4 (katër) takime në rajonin e gjykatave të apelit edhe atë: më 17 dhe 18 prill të vitit 2019 për Gjykatën e apelit Shtip, më 20 dhe 21 qershor të vitit 2019 për Gjykatën e apelit Manastir, më 19 dhe 20 shtator të vitit 2019 për Gjykatën e apelit Gostivar dhe më 23 dhjetor të vitit 2019 për Gjykatën e apelit Shkup. Në këtë mënyrë, mundësohet unifikimi në zbatimin e drejtë të ligjit në gjykatat, sa i përket zbatimit dhe citimit të praktikës së Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut, në vendimet e gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Njëkohësisht në mbledhjen e njëjtë është konstatuar mënyra e përgatitjes dhe punës së mbledhjeve të Sektorit të praktikës gjyqësore, duke marrë parasysh vëllimin e materialeve të cilat ekspozohen në mbledhjet, e me qëllim për njoftimin me kohë të anëtarëve të Sektorit të praktikës gjyqësore me lëndët dhe çështjet juridike që dalin nga të njëjtat. Në fakt, pasi që të evidentohet lëndë me SPR numër, për të cilën do të konstatohet se ka nevojë të shqyrtohet në mbledhjen e Sektorit të praktikës gjyqësore, i njëjti skanohet dhe vendoset në një dosje për anëtarët e Sektorit të praktikës gjyqësore, respektivisht në dosjen LIGJE (që gjendet në Desktop ose sipërfaqen punuese të çdo kompjuteri statik), në nëndosjen MBLEDHJE – Praktika gjyqësore, dosje “Material i ri për mbledhje të Sektorit”. Në këtë mënyrë, u harmonizua edhe një mënyrë e re e mbajtjes së mbledhjeve të Sektorit të praktikës gjyqësore, nëpërmjet kompjuterëve personal, me asistencë të IT qendrës së Gjykatës.

VII. Sektori i praktikës gjyqësore në drejtim të ndjekjes, studimit dhe pjesëmarrjes në harmonizimin e praktikës gjyqësore – zbatimin e barabartë të ligjeve në nivel të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë dhe gjykatat në Republikën e Maqedonisë së Veriut, organizoi takim të përbashkët të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut me gjykatat e apelit, me temë Sinkronizimi në zbatimin e ligjeve dhe praktikës gjyqësore „Koncepti i punës dhe sinkronizimi“. Takimi i përbashkët u mbajt në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut në datën

07.03.2019, dhe në të njëjtën morën pjesë Kryetari i Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe përfaqësues të Kabinetit, Kryetari, gjyqtarët dhe kuadri profesional i këshillit të Sektorit të praktikës gjyqësore, kryetarët e gjykatave të apelit, kryetarët e sektorëve të çdo gjykate të apelit, përfaqësues të Qendrës për hulumtime dhe analiza juridike dhe z. Gjuro Sesa Kryetar i Gjykatës supreme të Republikës së Kroacisë, në cilësinë e ekspertit ndërkombëtar dhe konsultant i emëruar për Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, i zgjedhur nëpërmjet të mekanizimit për koordinimin ekspert që zbatohet në suaza të Unionit Evropian, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës përkrahjen horizontale të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Në këtë takim janë miratuar konkluzione për dy çështje juridike për të cilat është arritur pajtueshmëri për qëndrimet e gjykatave, përderisa për dy çështje juridike për shkak të qëndrimeve të ndryshme të gjykatave është konstatuar që të njëjtat të shqyrtohen në Takimin punues të radhës të katër gjykatave të apelit. Procesverbali nga Takimi i përbashkët me konkluzionet e miratuara është publikuar në UEB faqen e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

VIII. Gjatë vitit 2019 nëpërmjet Sektorit të praktikës gjyqësore, Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut e ndoqi praktikën e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut në Strasburg nëpërmjet analizës së vendimeve dhe seleksionimit me qëllim për implementimin më lehtë së të njëjtëve në vendimet e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ashtu, në suaza të programit “Përmirësimi i transparencës, sigurisë juridike dhe efikasitetit të gjyqësisë në Maqedoni”, aktivitetet e të cilës realizohen në bashkëpunim me Qendrën për hulumtime dhe analiza juridike, ndërsa mbështeten nga ana e Ambasadës së Britanisë në Shkup, në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut u angazhua Velimir Dellovski në cilësinë e bashkëpunëtorit të jashtëm (konsultant) në Sektorin e praktikës gjyqësore. Materialet e përgatitura që përfshijnë kategorizimin sipas anëtarëve në përputhje me Konventën Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, në aktgjykimet e sjella nga Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut, rrjedhimisht janë azhurnuar në nëndosje përkatëse në dosjen “Praktika gjyqësore e GJEDNJ”, e krijuar në dosjen ekzistuese “Praktika gjyqësore”, ashtu që në mënyrë interne janë të disponueshme për të gjithë gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional.

VENDIME TË ANONIMIZUARA, TË PUBLIKUARA NË UEB FAQEN E GJYKATËS

Publikimi i vendimeve në ueb faqen e gjykatës zhvillohet vazhdimisht në përputhje me Ligjin e paraparë për administrimin e procedimit të lëndëve, të shfaqur në tabelën sipas sferave

Tabela 1

Penale	368
Civile	985
Afat të arsyeshëm PSRRG – PSRRK – PSRRU	276
Afat të arsyeshëm për ankesa PSRRZH	116
USPIZH	22
UZZ	7
GJITHSEJ:	1.774

Informacione nga Zyra për marrëdhënie me publikun

Zyra për marrëdhënie me publikun pranë Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë vazhdimisht publikon njoftime në Portalin gjyqësor me qëllim të informimit të opinionit për punën e Gjykatës, informacione për aktivitetet e kryetarit dhe të gjyqtarëve, pjesëmarrjen e tyre në konferenca ndërkombëtare, seminare, punëtori, trajnime dhe mbledhje, si dhe informimin e opinionit për takimet dhe vizitat nga delegacione dhe përfaqësues të institucioneve, projekte në të cilat përfshihet Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Njoftimet publikohen edhe për lëndë që shfaqin interes të madh në opinion.

KËRKESA PËR QASJE TË LIRË NË INFORMACIONE TË KARAKTERIT PUBLIK

Në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në vitin 2019 të pranuar janë:
30 – kërkesa për qasje të lirë në informacione sipas Ligjit për qasje të lirë në informacione të karakterit publik.

2 – ankesa të parashtruara nga palët nëpërmjet Komisionit për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informacione të karakterit publik, nga të cilat të njëjtat janë për lëndë të vitit 2019.

1 — ankesë e aprovuar me ATVENDIM nr. 08 – 258 nga data 13.02.2019 të Komisionit për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informacione të karakterit publik për lëndën SPI.nr. 21/2018-3.

Për të gjitha kërkesat është vepruar dhe janë dhënë përgjigje sipas Ligjit për qasje të lirë në informacione me karakter publik gjatë vitit 2019, në këtë mënyrë: me përgjigje të kërkesave, me shënime zyrtare me kërkesë me gojë të kërkuarit, me dërgime të kërkesave, me konkluzion për ndërprerjen e procedurës dhe sipas Ligjit të ri për qasje të lirë në informata me karakter publik (Gazeta zyrtare e RMV.nr.101/2019) për një kërkesë është vepruar me aktvendim me të cilin kërkesa e palës aprohet.

PUNA NGA MBLEDHJA E PËRGJITHSHME E GJYKATËS SUPREME TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT (neni 37 nga Ligji për gjykatat)

Sipas nenit 37 të Ligjit për gjykatat në plotësimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore, kryetari dhe të gjithë gjyqtarët e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut morën pjesë në punën e mbledhjes së përgjithshme.

Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë vitit **2019** ka mbajtur **16 Mbledhje të përgjithshme** në të cilat janë shqyrtuar shumë çështje:

- Mbledhja e përgjithshme me kërkesën e mendimit të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për numrin orientues të lëndëve që duhet t'i kryejë gjykatësi për një muaj për arsye të miratimit të Vendimit për normën orientuese për vitin 2019, dha mendim se gjykatësit e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk duhet të obligohen me normë orientuese.

- Është miratuar Raporti i punës së Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2018.

- Mbledhja e përgjithshme vendosi për 2 (dy) ankesa të gjykatësve kundër vendime për orarin e punës së kryetarëve të gjykatave.

- Mbledhja e përgjithshme shqyrtoi 8 (tetë) iniciativa për konstatimin e mendimeve juridike.

- Janë shqyrtuar 3 (tre) çështje juridike.

- Janë miratuar 2 (dy) mendime juridike parimore.

- Në mbledhjen e përgjithshme të zgjeruar janë shqyrtuar Raportet e punës së gjyqtarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2018.

- Mbledhja e përgjithshme shqyrtoi për 9 (nëntë) kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë.

- Janë miratuar vlerësimet dhe konkluzionet për raportet e punës së gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2018.

- Mbledhja e përgjithshme zgjodhi anëtarë për 3 (tre) këshillat për vendimmarrje sipas ankesave kundër vendimeve të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- Mbledhja e përgjithshme morri vendim për përjashtimin e UD kryetarit dhe të gjyqtarëve të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut në formimin e këshillave ankuese për vendimmarrjen sipas ankesave kundër vendimit të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- Mbledhja e përgjithshme miratoi Kodin etik të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë, me propozimin e Shoqatës së gjyqtarëve.
- Mbledhja e përgjithshme dha mendim për numrin optimal të gjykatësve në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me kërkesë të Këshillit gjyqësor të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- Është marrë mendim për Raportin vjetor të punës së gjyqtarëve të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2020.
- Janë dhënë mendime për 5 propozim ligje të dorëzuara nga Ministria e drejtësisë edhe atë:
 - propozim Ligji për procedurë penale,
 - propozim Ligji për provimin e jurisprudencës,
 - propozim Ligji për bashkëpunimin ndërkombëtar në materien penale,
 - propozim Ligji për administrimin e procesionit të lëndëve në gjykatat dhe
 - propozim Ligji për pagesën e kompensimit në para viktimave të veprës penale me dhunë.

MBLEDHJE TË GJYQTARËVE

Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë vitit **2019** ka mbajtur gjithsej **6 Mbledhje të gjyqtarëve** në të cilat:

- Është shqyrtuar gjendja me pagesën e shtesave të rrogave, konteste të filluara gjyqësore dhe propozime për tejkalimin e situatave, në atë kuptim që mbledhja e gjyqtarëve miratoi konkluzion se marrëveshja me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut është solucion më i mirë se sa udhëheqja me konteste gjyqësore;
- Është formuar komisioni tre anëtarësh për dhënien e mendimit në Këshillin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për vlerësimin e kryetarit të gjykatës dhe gjyqtarëve të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të përbërë nga kryetari i gjykatës dhe dy gjyqtarë të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Është formuar komisioni tre anëtarësh për dhënien e mendimit në Këshillin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për vlerësimin e kryetarëve të sektorëve në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të përbërë nga kryetari i gjykatës dhe dy gjyqtarë - kryetarë të sektorëve tjerë ose gjyqtarë nga Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Janë shqyrtuar çështje tjera me kuptim të punës së Gjykatës, para se gjithash sjellja e gjyqtarëve të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut në punën e tërësishme të Gjykatës.

MBLEDHJET E SEKTORËVE GJYQËSOR

SEKTORI I VEPRAVE PENALE

Sektori i veprave penale gjatë vitit 2019 në mbledhjet e mbajtura, ka vepruar dhe shqyrtuar sipas materialeve të marra, për çështje dhe iniciativa të parashtruara nga gjykatat themelore dhe të apelit, si dhe nga avokatë.

Më datë 23.01.2019, është mbajtur mbledhje e Sektorit të veprave penale, në të cilën me shumicë votash 4:1 u miratua në vijim:

MENDIM JURIDIK

Prokuroria publike për ndjekje të veprave penale, që kanë të bëjnë dhe të cilat rrjedhin nga përmbajtja e ndjekjes së paligjshme të komunikimeve, mund të ngre akuzë ose të urdhërojë ndërprerjen e procedurës hetuese, në periudhën jo më gjatë se 18 muaj nga dita e marrjes së lëndëve dhe materialet nga kompetenca e saj si kusht akumulimi.

Prokuroria publike për ndjekje të veprave penale, që kanë të bëjnë dhe të cilat rrjedhin nga përmbajtja e ndjekjes së paligjshme të komunikimeve, pas skadimit të afatit prej 18 muaj nga dita e marrjes së lëndëve dhe materialet nga kompetenca e saj si kusht akumulimi, nuk është paditës i autorizuar për marrjen përsipër të punëve prokurore publike të veprimeve para hetuese dhe hetuese, të parapara me Ligjin për procedurë penale. Po ashtu, është miratuar që Kryetari i sektorit të formulojë tekstin gjuhësor të korrigjuar gramatikisht të mendimit juridik dhe referatin e Mbledhjes së përgjithshme të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë.

Më datë 20.03.2019, u mbajt mbledhja e Sektorit të veprave penale, në të cilën u shqyrtua dhe u miratua raporti vjetor i Sektorit të veprave penale të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2018.

Më datë 25.09.2019, u mbajt mbledhja e Sektorit të veprave penale, në të cilën u shqyrtuan më shumë pika për të cilat u miratuan konkluzione. Pas kërkesës të parashtruar të Kryetarit të Gjykatës së apelit Shtip që ka të bëjë me zbatimin e ligjit të ri për kundërvajtje i cili është më i butë për kryerësit është miratuar konkluzion që gjykatat me detyrë zyrtare gjatë rrjedhjes së procedimit të kenë kujdes në zbatimin e ligjit më të butë, ndërsa gjyqtarët në çdo rast konkret varësisht nga rrethanat e rastit të vlerësojnë për zbatimin e ligjit më të butë për kundërvajtje në procedimin dhe vendimmarrjen sipas lëndëve konkrete. Po ashtu është miratuar konkluzioni se për kërkesën e mendimit juridik të gjyqtarit të procedurës paraprake nga Gjykata themelore Shkup I Shkup në lidhje me nenin 22 të Ligjit për Prokurorinë Speciale Publike të njoftohet gjyqtari se kjo gjykatë për këtë çështje ka miratuar mendim juridik parimor më 30.01.2019. U shqyrtua për kërkesën e Gjykatës së apelit, për miratimin e mendimit juridik për zbatimin e bazave për përjashtimin e gjyqtarit në përputhje me nenin 33 paragrafi 1 pika 4 dhe 5 të Ligjit për procedurë penale. Në të njëjtën mbledhje u miratua siç vijon:

Më datë 02.10.2019, u mbajt mbledhja e Sektorit të veprave penale, në të cilën u shqyrtuan iniciativa, kërkesa, konkluzione të Trupit punues për standardizimin e procedurave në gjykatat, si dhe përshtatja e sistemit AKMIS në këtë gjykatë me ligjin e ri për procedurë penale. Në këtë mbledhje u shqyrtua dhe u miratua konkluzioni për përgatitjen e planit për mendimin juridik se gjyqtari i cili ka marrë pjesë në këshillin për vlerësimin e aktit akuzues dhe ka vepruar për ankesën e parashtruar kundër aktit akuzues dhe është miratuar vendim për hedhjen e të njëjtës, që është vendim procedues formal, i njëjti nuk ka marrë pjesë në mënyrë meritore në vendimmarrjen në shqyrtimin kryesor, ashtu që nuk ka pengesë që i njëjti gjyqtarë në aspektin e paanshmërisë së tij kur ka vepruar si anëtarë i këshillit në gjykatën e shkallës së dytë dhe ka marrë vendim për ankesën në mënyrë meritore për çështjen kryesore, ashtu që në rastin konkret nuk ka bazë për përjashtimin e atij gjyqtari në përputhje me nenin 33 paragrafi 1 pika 4 dhe 5 të Ligjit për procedurë penale.

Më datë 03.10.2019, u mbajt mbledhja e Sektorit të veprave penale, në të cilën u shqyrtua gjendja me lëndët që kanë mbetur të vjetra nga gjyqtarët Jovo Vangelovski dhe Rahillka Stojkovska dhe u miratuan konkluzione që lëndët të rishpërndahen në sistemin AKMIS, t'i jepen gjyqtarës Cvetanka Periq dhe të njëjtët të referohen përsëri, të cilët kanë qenë të referuara e nuk kanë qenë të kryera, si edhe lëndët të cilat kanë qenë të kryera por nuk kanë qenë të nënshkuara nga të gjithë gjyqtarët e këshillit t'i kthehen gjyqtarit referues që përsëri të referohen.

Më datë 07.11.2019, u mbajt mbledhja e Sektorit të veprave penale, në të cilat u shqyrtua plani i mendimit juridik për përjashtimin e gjyqtarit, sipas nenit 33 paragrafi 1 pika 4 dhe 5 të Ligjit për procedurë penale dhe u miratua konkluzion që plani për mendimin juridik të aprovohet.

Më datë 27.11.2019, në mbledhjen e Sektorit të veprave penale u shqyrtuan, korrigjuan dhe u miratua mendimi juridik, i cili ishte ndër pikët e radhës ditore dhe në mbledhjen e Sektorit të veprave penale më datë 07.11.2019 është miratuar siç vijon:

MENDIM JURIDIK

Gjyqtari i cili ka marrë pjesë si anëtarë në Këshillin penal të procedurës ankimore kundër vendimit të këshillit për vlerësimin e aktakuzës, në kuptim të nenit 328 paragrafi 2 të Ligjit për procedurë penale, kur kundërshtimi i parashtruar kundër aktakuzës hidhet si jo me kohë, ose si i palejueshëm, mund të jetë anëtarë i këshillit dhe në mënyrë meritore të marrë vendim për ankesën e deklaruar në gjykatën e shkallës së dytë kundër aktgjykimit të shkallës së parë për çështjen kryesore.

SEKTORI I VEPRAVE CIVILE

Në vitin 2019 Sektori i veprave civile, **mbajti 10 mbledhje** nga të cilat dy mbledhje u shtynë për shkak të mos plotësimit të kushteve për mbajtjen e tyre. Në këtë mbledhje u shqyrtuan për çështje të ndryshme juridike të cilat kishin të bëjnë në lëndët, çështje juridike dhe probleme nga parashtrues të gjykatave themelore dhe të apeleve si dhe nga parashtrues të tjerë, për të cilat janë konstatuar **4 mendime juridike**, nga të cilat tre janë publikuar në ueb faqen, ndërsa një mendim juridik është në procedurë të publikimit dhe **9 të konstatuara dhe sentenca të publikuara**. Në Sektorin e veprave civile është vepruar për **104 lëndë të ndryshme civile** të regjistruara me shenjë Gr. Gjyqtarët e Sektorit të veprave civile gjatë vitit raportues, krahas angazhimit me lëndët kanë marrë pjesë edhe në trupa punues dhe komisione të shumë projekteve ligjore, seminare, edukime dhe udhëtime studiuuese, si dhe pjesëmarrja e disa gjyqtarëve si anëtarë të organeve të Akademisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë, ashtu që angazhimi i tillë i tyre nuk ka ndikuar negativisht në punën e rregullt të Sektorit, njëkohësisht janë realizuar edhe takime të posaçme pune me sektorët e veprave civile të Gjykatave të Apelit.

SEKTORI PËR AFAT TË ARSYESHËM

Në vitin 2019, Sektori për gjykim në afat të arsyeshëm të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut mbajti **1- një mbledhje të Sektorit**, në të cilën u shqyrtuan çështje të rëndësishme juridike që kanë të bëjnë me lëndët e formuara të kërkesave për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, njëkohësisht u shqyrtuan Raporti i punës së Sektorit për gjykim në afat të arsyeshëm për vitin 2018 dhe Propozim – programi i punës së Sektorit për gjykim në afat të arsyeshëm për vitin 2019.

SEKTORI I PRAKTIKËS GJYQËSORE

Në vitin 2019 është rritur numri i kërkesave të parashtruara sipas nenit 37 të Ligjit për gjykata, me të cilat kërkohet nga Mbledhja e përgjithshme e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë të konstatojë qëndrim parimor dhe mendim juridik parimor, Sektori i praktikës gjyqësore në mbledhjen e mbajtur më 05.07.2019, miratoi në vijim:

KONKLuzion

Të gjitha iniciativat e parashtruara në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut që kanë të bëjnë me përshtatjen e praktikës gjyqësore, për mendime juridike parimore dhe qëndrime juridike parimore të evidentohen në regjistër të veçantë – libër dhe të dorëzohen në Sektorin e praktikës gjyqësore. Sektori i praktikës gjyqësore iniciativat aktuale të parashtruara i prezanton në mbledhjet e Sektorit dhe me konkluzion i udhëzon në procedimin e mëtejshëm të Mbledhjes së përgjithshme.

Çështja e procedimit të iniciativave për mendimet juridike parimore dhe qëndrimet juridike parimore të rregullohet në Rregulloren e Gjykatës supreme.

Në këtë drejtim, Sektori i praktikës gjyqësore i shqyrton lëndët SPR, dhe varësisht nga çështja juridike që rrjedh nga materialet dhe propozon në Mbledhjen e përgjithshme që të konstatojë nevojën për miratimin e mendimit juridik parimor dhe me konkluzion të caktosh një gjyqtarë për të përgatitur referat, për të cilin do të merr vendim ose do të miratojë konkluzion me të cilin do të konstatojë se nga materiali i bashkëngjitur nuk del se nevojitet miratim të mendimit juridik parimor dhe qëndrim juridik parimor.

VIZITA DHE BASHKËPUNIME NDËRKOMBËTARE

Vizita ndërkombëtare të Kryetarit dhe gjyqtarëve të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut:

Kryetari i Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me ftesë të Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit të Francës dhe Prokurorit publik në këtë gjykatë, morri pjesë në solemnitetin me rastin e hapjes formale të vitit të gjyqtarëve, që u mbajt në Gjykatën e Kasacionit të Francës në Paris më 14 janar të vitit 2019.

Një delegacion i Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, i përbërë nga kryetari i gjykatës, dy gjyqtarë, me ftesë të Kryetarit të Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut morri pjesë në solemnitetin tradicional me rastin e punës vjetore të Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut në Strasburg. Në suaza të solemnitetit që u mbajt më 28 janar të vitit 2019, u mbajt seminar i titulluar “Përforcimi i besimit në gjyqësinë”.

Kryetari dhe gjyqtari i Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, morën pjesë në të gjashtin me radhë Forumin rajonal vjetor dedikuar sundimit të së drejtës, që u mbajt më 22 dhe 23 mars të vitit 2019 në Dubrovnik, Republika e Kroacisë.

Kryetari i Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut me ftesë të Gjykatës supreme të Republikës së Sllovakisë morri pjesë në punën e konferencës së Nëntë me radhë të kryetarëve të gjykatave supreme të Evropës Qendrore dhe Lindore, që u mbajt prej 26 deri më 29 maj të vitit 2019 në Bratislavë, Republika e Sllovakisë.

Gjyqtarë nga Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me ftesë të Gjykatës supreme të Malit të Zi, morën pjesë në punën e Konferencës së kryetarëve të gjykatave supreme dhe prokurorëve publik, që u mbajt prej 24 deri më 26 qershor të vitit 2019 në Beçiqi, Budvë, Mali i Zi.

Kryetari i Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, morri pjesë në solemnitetin me rastin e marrjes së funksionit të ri të zgjedhur Kryetarë i Parë i Gjykatës së Kasacionit të Republikës së Francës, z – a Shantall Arens. Solemniteti u mbajt më 6 shtator të vitit 2019 në Sallën e madhe të Gjykatës së Kasacionit në Paris, Republika e Francës, në prani të përfaqësuesve të gjykatave më të larta nga e tërë bota.

UD Kryetari dhe një gjyqtarë i Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me ftesë të Drejtorisë gjenerale për të drejtat e njeriut dhe sundimin e të drejtës së Këshillit të Evropës, morën pjesë në punën e konferencës rajonale me temë: “Ndarja e përgjegjësisë në zbatimin e Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut; tejkalimi i sfidave nëpërmjet shfrytëzimit të mjeteve të reja juridike”. Konferenca rajonale u mbajt më 24 dhe 25 tetor të vitit 2019 në Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë.

UD Kryetari i Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe një gjyqtarë, morën pjesë në punën e Konferencës së Nëntë me radhë të Këshillit gjyqësor të Kosovës, që u mbajt më 07 dhjetor të vitit 2019, në Prishtinë, Kosovë.

Gjatë vitit, Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë e vizituan delegacione dhe përfaqësues të shumë organizatave ndërkombëtare dhe institucioneve:

Kryetari i Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe anëtarë të Kabinetit, më 08 shkurt të vitit 2019 realizuan takim me N.E. z – nja Keiko Haneda, ambasadore e Japonisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Kryetari i Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut më 13 shkurt të vitit 2019, në lokalet e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, përsëri realizoi takim me kryetarin e Gjykatës supreme të Republikës së Kroacisë, z . Gjuro Sesa, ekspert ndërkombëtar dhe konsultant për Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për implementimin praktik

të Strategjisë nacionale për reformat në sektorin gjyqësor dhe planin aksionar në përputhje me praktikën dhe standardet evropiane.

Në vizitë dyditore të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, qëndroi z-nja Alise Proy, ndjekëse e Akademisë së gjyqtarëve në Republikën e Francës. Gjatë vizitës më 18 dhe 19 shkurt të vitit 2019, z – nja Proy realizoi takim me kryetarin e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe me gjyqtarë tjerë dhe u informua me punën e Sektorit të veprave penale dhe të Sektorit të veprave civile.

Kryetari i Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut më 20 shkurt të vitit 2019, realizoi takim me N. E. Z- nja Kristijan Timonie, ambasador i Republikës së Francës në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në takim morën pjesë edhe z – nja Julie Maraval, atashe për bashkëpunimin në Ambasadën e Francës dhe z – nja Alise Proy, ndjekëse e Akademisë së gjyqtarëve në Republikën e Francës.

Kryetari dhe gjyqtari i Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe anëtarët e kabinetit më 06 mars të vitit 2019, realizuan takim me ambasadorin e Republikës Popullore të Kinës në Republikën e Maqedonisë së Veriut N. E. z – nja Jin Lisjen.

Kryetari i Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më 11 prill të vitit 2019 realizoi takim pune me z. Tom Gallovej dhe z – a Iskra Andreeva nga Ambasada e Britanisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në takim morën pjesë edhe Rahillka Stojkovska, gjyqtar në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe z – Zharko Haxhi – Zafirov, përfaqësues nga Qendra për hulumtime dhe analiza juridike.

Kryetari i Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe anëtarë të kabinetit, në lokalet e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut më 14 mars të vitit 2019, realizuan takim me ambasadorin Samuell Zhbogar, shef i Delegacionit të Unionit Evropian në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në takim morën pjesë edhe Mr. Faik Arslani, gjyqtarë i Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, anëtarë të Kabinetit të kryetarit dhe përfaqësues nga Delegacioni i Unionit Evropian në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Kryetari i Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më 30 Maj të vitit 2019, realizoi takim me z – nja Lise Kristofersen, Norvegji, Grup i Socialistëve, Demokratëve dhe të Gjelbërit, z. Valeriu Gileçi, Molldavi, Grupi i Partisë Popullore Evropiane – si referues të Komisionit të Monitoringut të Kuvendit Parlamentar të Këshillit të Evropës dhe z – nja Sillvi Afholder, sekretar i Komisionit të Monitoringut. Në takim morën pjesë edhe Mr. Faik Arslani, gjyqtarë që e zëvendëson kryetarin e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe anëtarë të kabinetit të kryetarit.

Kryetari i Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më 06 qershor të vitit 2019, në lokalet e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, realizoi takim me përfaqësues të Bankës Botërore, z. Sërgjan Svircev, specialist i lartë i sektorit publik. Në takim morën pjesë edhe Mr. Faik Arslani, gjyqtarë i Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe anëtarë të kabinetit të kryetarit.

Kryetari i Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më 12 korrik të vitit 2019, në lokalet e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, realizoi takim me N. E. z. Emilio Lorenzo Sera, ambasador i Mbretërisë së Spanjës në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Kryetari i Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më 27 gusht të vitit 2019, në lokalet e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, realizoi takim me z – sha Ana Zec, shef në Zyrën e Programit të Këshillit të Evropës në Shkup.

UD Kryetari i Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Mr. Faik Arslani, në lokalet e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut më 17 tetor të vitit 2019, realizoi takim me ambasadorin Samuell Zhbogar, shef i Delegacionit të Unionit Evropian në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në këtë mbledhje morën pjesë z – sha Marina Kurte, përfaqësues nga Delegacioni i Unionit Evropian në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe anëtarë të kabinetit të kryetarit.

UD Kryetari i Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në lokalet e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut më 22 tetor të vitit 2019, realizoi takim me përfaqësues të Ambasadës së SHBA – ve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, z -sha Dajana Palekvin, shef i programit INL Zyra politike dhe sundimi i të drejtës dhe z – sha Çellsi Shinur, shef i programit OPDAT.

UD Kryetari i Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut më 11 dhjetor të vitit 2019, realizoi takim me N.E. z. Dirk Jan Kop, ambasador i Mbretërisë së Holandës në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

UD Kryetari i Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut më 12 dhjetor të vitit 2019, realizoi takim me shefin e Misionit të OSBE në Shkup, ambasadorin Kllemens Koja.

UD Kryetari i Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut më 18 dhjetor të vitit 2019, realizoi takim me N.E. z – sha Rejçell Gallovej, ambasador i Mbretërisë së Bashkuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

QENDRA E INFORMATIKËS

Në Qendrën e informatikës së Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut është vendosur pajisje harduerike – softuerike e tërësishme nga sfera e IKT dedikuar për funksionimin papengesë të GJSRMV dhe një pjesë për gjykatat e RMV dhe KGJRMV. Plotësuese në Qendrën e informatikës janë vendosur baza të caktuara të centralizuara për të dhënat, funksionalitetin centralizues, këmbimin e të dhënave të centralizuara me institucione nga jashtë etj., që dedikohen për punën pa pengesë për të gjitha gjykatat. Aktivitetet themelore për funksionimin pa pengesë për implementimin e sistemit IKT (planifikimin, pjesëmarrjen në projekte IKT zhvilluese, administrimin, menaxhimin, monitoring, mbrojtje, siguri, prokurime publike të centralizuara, përkrahja e shfrytëzuesve etj.) janë në perimetër të detyrave punuese të gjithsej 4 (katër) IT inxhinierëve të punësuar në Qendrën e informatikës së GJSRMV.

Në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut në funksion janë aplikacionet e shfrytëzuesve nga sfera e IKT me tendencë të rritjes së tyre në periudhën e ardhshme siç vijon:

- Aplikacioni për administrimin e procesionit të lëndëve gjyqësore (AKMIS).
- Aplikacioni për punën financiare dhe materiale (ABMS).
- Aplikacioni për publikimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës supreme të RMV dhe vendime të gjykatave të apelit në Ueb faqen e praktikës gjyqësore.
- Aplikacioni për publikimin e vendimeve gjyqësore, informacioneve, informacione të reja, të dhëna statistikore e të tjera të WEB faqes së Gjykatës supreme të RMV.
- Vendosjen e centralizuar të Ueb Portalit gjyqësor dhe WEB faqes së të gjitha gjykatave të RMV.
- Sistemi i postës elektronike dedikuar për të punësuarit e Gjykatës supreme të RMV dhe për njoftimin e shfrytëzuesve të sistemit për Dorëzimin elektronik të dokumenteve gjyqësore
- Aplikacioni për dorëzimin elektronik të dokumenteve gjyqësore (faza e parë – dorëzimi nga gjykatat te shfrytëzuesit), dedikuar për të gjitha gjykatat e RMV, me bazë të centralizuar për të dhënat e vendosura në Gjykatën supreme të RMV.
- Aplikacioni i evidencës ndëshkuese e dedikuar për të gjitha gjykatat e RMV, me bazë të centralizuar të vendosur në Gjykatën supreme të RMV.
- Servisi i centralizuar për këmbimin e të dhënave të drejtorëve të falimentimit me Regjistër Qendror të RMV, dedikuar për të gjitha gjykatat e RMV.
- Servis i centralizuar për këmbimin e të dhënave ndërmjet gjykatave dhe prokurorive të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- Servis i centralizuar për këmbimin e të dhënave ndërmjet gjykatave dhe Gazetës zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

IT inxhinierët e punësuar në Qendrën e informatikës së Gjykatës supreme të RMV gjatë vitit 2019 kanë realizuar aktivitetet siç vijon:

- Konstatimin e nevojave, përpunimin e specifikimit teknik të detajuar dhe kriteret për konstatimin e aftësisë, pjesëmarrjen në evoluim dhe realizimin (dhënia e përkrahjes teknike dhe ndjekja e përparimit në përputhje me planet e nënvizuara me afat) e procedurave për prokurim publik të

cilat i përfshijnë nevojat e të gjitha gjykatave të RMV dhe Këshillit gjyqësor të RMV nga sfera e IKT siç vijon:

- Mirëmbajtja harduerike – softuerike të pajisjes të siguruar në suaza të projektit kryesisht mirëmbajtjen preventive dhe adaptuese të ueb faqeve së të gjitha gjykatave të RMV dhe të Këshillit gjyqësor të RMV
 - Mirëmbajtja adaptuese dhe preventive e sistemit AKMIS të implementuar në gjykatat e Republikës së Maqedonisë së Veriut kryesisht edhe mirëmbajtjen e aplikacioneve plotësuese dhe servisimin integrues në të njëjtin
 - Mirëmbajtjen e Platformës IBM Lotus Domino, sistemin e – mail dhe aplikacionin ueb për publikimin e vendimeve nga praktika gjyqësore e Gjykatës supreme të RMV
 - Mirëmbajtjen harduerike – softuerike dhe parapagesën vjetore të softuerit të Firewall Check Point arkitekturën implementuese në të gjitha gjykatat e RMV dhe Këshillit gjyqësor të RMV
 - Mirëmbajtjen harduerike – softuerike dhe parapagesën vjetore të softuerit të VMware infrastrukturën implementuese në të gjitha gjykatat të RMV dhe Këshillit gjyqësor të RMV
 - Mirëmbajtjen e softuerit për grumbullimin, analizën dhe kërkimin e shënimeve log të pajisjeve të IKT të vendosura në GJSRMV
 - Mirëmbajtjen harduerike – softuerike dhe parapagesën vjetore të sistemit për mbrojtjen e bazës së të dhënave në të gjitha gjykatat e RMV dhe Këshillit gjyqësor të RMV
 - Mirëmbajtjen e post – garancisë së sistemit për klimatizimin preciz në sistem sallën e Gjykatës supreme të RMV
 - Mirëmbajtjen e sistemit UPS të vendosur në ndërtesën e Gjykatës supreme të RMV
 - Ripërtëritjen e licencave për pakon softuerike integruese për mbrojtjen e tërësishme kundër virusale dhe kundër postave të bezdisshme të pajisjes IKT në të gjitha gjykatat e RMV dhe Këshillit gjyqësor të RMV
 - Pjesëmarrjen në Grupin punues të formuar nga Këshilli gjyqësor të RMV për përpunimin e specifikës teknike dhe kriterëve për konstatimin e aftësisë në procedurën për furnizimin me internet linqe për të gjitha gjykatat e RMV dhe Këshillit gjyqësor të RMV.
 - Furnizimi me materialet AOP për nevojat e Gjykatës supreme të RMV
- Ndjekja e vazhdueshme e gjendjes dhe marrjes përsipër e aktiviteteve adekuate me qëllim të funksionimit papengesë të aplikacioneve implementuese të shfrytëzuesve të dedikuara për GJSRMV dhe një pjesë për të gjitha gjykatat e RMV, në zbatimin e të gjitha fazave të tyre:
- Vërejtjen e pengesave të paraqitura, probleme të paparapara, vërejtje dhe korrespondenca me përgatitësin e aplikacionit shfrytëzues për mënjanimin e tyre
 - Perceptimi i nevojave eventuale të përmirësimit
 - Ndarja adekuate e të drejtave të shfrytëzuesve dhe privilegjet
 - Mbështetja teknike e shfrytëzuesve të brendshëm dhe të jashtëm të cilët i drejtohen Qendrës së informatikës dhe kërkojnë ndihmë
 - Përpunimi i raporteve të ndryshme për nevojat e shërbimeve gjyqësore dhe institucionet tjera
- Planifikimi i mjeteve të nevojshme financiare për investimin dhe mirëmbajtjen në sferën IKT për të gjitha gjykatat e RMV dhe KGJRMV, planifikimin e nevojshëm për edukimin e vazhdueshëm të kuadros IT të punësuar në gjykatat e RMV dhe planifikimi i nevojshëm për punësime të reja të kuadros profesionale IT në Qendrën e informatikës së Gjykatës supreme të RMV.
- Administrimin gradual, menaxhimin dhe ndjekjen e sistemeve IKT të cilat janë të vendosura në Qendrën e informatikës të Gjykatës supreme të RMV dhe një pjesë për të gjitha gjykatat e RMV.
- Realizimi i përditshëm dhe kontrollimi i procedurave për mbrojtjen e të dhënave sistemuere dhe shfrytëzuese (backup) të dedikuara për Gjykatën supreme të RMV dhe një pjesë për të gjitha gjykatat e RMV.
- Monitorimin e logo sistemeve për paraqitjen e gabimeve të pajisjes së tërësishme të IKT, të vendosur në Qendrën e informatikës të Gjykatës supreme të RMV me qëllim për mënjanimin eventual të problemeve që hasen.
- Ndjekja në vazhdimësi e performancave të sistemeve IKT të vendosura me qëllim për marrjen përsipër të aktiviteteve përkatëse ose pasqyrimin e nevojave për përmirësimin e tyre.
- Mirëmbajtja në vazhdimësi dhe administrimi i stacioneve punuese, notebook kompjuterëve, printerëve, skanerëve.

- Bashkëpunimin dhe koordinimin e Qendrës së informatikës të GJSRMV me sektorë të informatikës të gjykatave në RMV dhe KGJRMV, me qëllim të dhënies së rekomandimeve dhe udhëzimeve për marrjen përsipër të aktiviteteve të caktuara lidhur me funksionet e centralizuar, raportimet për mirëmbajtjen e sigurt të sistemeve IKT të caktuara, procedura për lajmërimin e problemeve të shfaqura, dorëzimi i dokumentacionit të nevojshëm etj.
- Ndjekja e vazhdueshme e teknologjive dhe trendëve të reja në sferën e IT (pa edukim përkatës) duke shfrytëzuar literaturë të disponueshme në Internet.
- Udhëheqja me dokumentacion të rregullt për realizimin e aktiviteteve sistemuese dhe të shfrytëzuesve, probleme të shfaqura, mënjanimin e tyre, udhëheqjen me raporte mujore për realizimin e detyrave punuese të IT inxhinierëve nga Qendra e informatikës së GJSRMV dhe të ngjashme.
- Pjesëmarrja në mbledhjet punuese për realizimin e IPA2 projektit LOT4, takime të realizuara punuese, analiza dhe dorëzimi i të dhënave ekspertëve të angazhuar në suaza të projektit IPA2015 Mbështetja e reformave, pjesëmarrja në punën e Këshillit të sapoformuar të IKT.

Sipas të gjitha trendëve shoqërore bashkëkohore vet imponohet nevoja për futjen në vazhdim të teknologjive të reja informatike dhe sisteme IT në sistemin gjyqësor të RMV që të mund përmes teknologjisë informatike bashkëkohore, edukative, kompatible dhe unifikuese të arrihet qëllimi përfundimtar, realizimi i lidhshmërisë efikase në të gjitha gjykatat e territorit të RMV dhe këmbimin e të dhënave me institucione tjera. Ajo me automatizëm dhe dukshëm e zmadhon vëllimin e punës së vetëm 4 (katër) IT inxhinierëve ekzistues në Qendrën e informatikës pranë GJSRMV.

Adekuatë për të është evidente dhe e domosdoshme nevoja për punësimin e vazhdueshëm të IT inxhinierëve profesional në Qendrën e informatikës, të cilëve do tu mundësohet edukim i vazhdueshëm dhe adekuat duke marrë parasysh se teknologjia e informatikës është sistemi më dinamik në çdo shoqëri bashkëkohore.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE

1. Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, konstatoi se nga viti paraprak kanë mbetur të pakryera **1422** lëndë, të pranuar për vitin 2019 janë **2002** lëndë të reja, që do të thotë se Gjykata ka vepruar për gjithsej **3422** lëndë nga të gjitha llojet pa 7 lëndët e evidentuara gabimisht dhe me 5 lëndë përsëri në punë. Gjatë vitit janë kryer **2167**, ndërsa kanë mbetur të pakryera **1255** lëndë.

Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin raportues ka tejkaluar rritjen dhe ka zvogëluar numrin e lëndëve që kanë mbetur për **165** lëndë.

2. Në Sektorin e veprave penale në vitin raportues 2019, të pranuar kanë qenë 425 lëndë, respektivisht gjithsej në punë sipas të gjitha bazave kanë qenë 650 lëndë, nga të cilat të kryera janë 496 lëndë, nga të cilat 1 lëndë nga viti 2014, 8 lëndë nga viti 2015, 17 lëndë nga viti 2016, 63 lëndë nga viti 2017 dhe 122 lëndë nga viti 2018, ose gjithsej 211 lëndë që kanë mbetur nga vitet paraprake, ndërsa në fund të vitit kanë mbetur të pakryera 154 lëndë sipas të gjitha bazave. Numri i lëndëve të pakryera vjen nga disa faktorë objektiv, ndër të cilat edhe numri i lëndëve nga sfera e krimit të organizuar edhe atë lëndë të ndërlikuara të mëdha, me numër të konsiderueshëm të akuzuarve, që kërkojnë përpjekje të konsiderueshme, si dhe periudhë më të gjatë kohore për zotërimin efikas të tyre. Arsyet lidhur me natyrën dhe karakterin e lëndëve që ndikojnë në periudhën kohore për marrjen e vendimit të tyre, reflektohen edhe në kohëzgjatjen e procedurës për marrjen e mendimit nga prokuroria publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut .

Në numrin e lëndëve të pakryera, gjithsesi ndikon edhe fakti që një pjesë e të njëjtëve në gjykatë janë pranuar në fund të vitit raportues, për atë shkak nuk kanë mundur të merren në punë, për arsye se janë dhënë për mendim në Prokurorinë publike të Republikës së Maqedonisë.

Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut një periudhë të gjatë ballafaqohet me mungesën e një numri përkatës të gjyqtarëve, si dhe mungesën e bashkëpunëtorëve profesional. Rrethanat e tilla objektive përfaqësojnë shkaqe relevante dhe të arsyeshme që ndikojnë në prishjen e principit të azhurnimit. Megjithatë, edhe krahas resurseve të zvogëluara ashtu të vendosura, me organizimin e mirë me orarin e punës dhe bashkëpunimin aktiv së të gjithë shkaktarëve në këtë proces, Sektori i veprave penale vitin raportues e përfundoi me azhurnim, efikasitet dhe kualitet.

Gjyqtarët dhe këshilltarët gjyqësorë nga Sektori në vitin raportues 2019, kishin bashkëpunim të shkëlqyeshëm me udhëheqësin e byrosë së daktilografisë dhe me të gjithë daktilografist të cilët me durim, profesionalisht, me kohë dhe teknikisht në rregull i përpunojnë të gjitha vendimet dhe materialet tjera që ishin përgatitur nga gjyqtarët dhe këshilltarët.

3. Në Sektorin e veprave penale, në periudhën raportuese, ka pasur **gjithsej në punë 2.129** lëndë, nga të cilat **944 lëndë të pakryera** nga vitet paraprake, ndërsa **1.185 lëndë të reja të pranuar**. Krahasuar me vitin paraprak kur kanë qenë të pranuar 1204 lëndë, rritja e numrit të lëndëve në vitin 2019 është zvogëluar për 19 lëndë. Në vitin raportues janë **1.211 lëndë të kryera**, ndërsa kanë mbetur **918 lëndë të pakryera**. Në krahasim me vitin 2018 kur ka pasur **1.341 lëndë të kryera**, për shkak të ekipimit jo të plotë të gjyqtarëve, ka pasur **130 lëndë të kryera më pak**, por edhe krahas saj rritja e numrit është tejkaluar tërësisht ndërsa edhe numri i lëndëve që **kanë mbetur është zvogëluar për 26 lëndë**. Për shkak të punës efikase të gjyqtarëve nevojitet që të plotësohet numri i vendeve të punës për gjyqtarë.

4. Në Sektorin e veprave penale, në vitin raportues **gjithsej në punë** ka pasur **606 lëndë**, për të gjitha bazat, në të dyja shkallët e vendimmarrjes. Nga viti paraprak **gjithsej** ka pasur **235 lëndë të pakryera**. **Të reja të pranuar** ka pasur **gjithsej 371 lëndë**. Në vitin raportues 2019, **të kryera** kanë qenë gjithsej **429 lëndë**, ndërsa **të pakryera** kanë mbetur **177 lëndë**. Nga këtu, mund të përfundojmë se rritja e numrit është tejkaluar tërësisht, ndërsa numri i lëndëve që kanë mbetur është zvogëluar për gjithsej **58 lëndë**.

Në vitin raportues **2019**, krahasuar me vitin **2018**, është zvogëluar shuma e kompensimit gjithsej të përcaktuar në para të shqiptuar për shkak të konstatimit të cenimit për të drejtën e mbrojtjes për gjykim në afat të arsyeshëm. Ashtu që, kompensimi gjithsej i përcaktuar për konstatimin e cenimit për të drejtën e gjykimit në afat të arsyeshëm, në vitin **2018** në **shkallën e parë** ka qenë **4.233.000** denarë, ndërsa në shkallën dytë ka qenë shuma **317.900** denarë, respektivisht gjithsej shuma në **të dyja shkallët** prej **4.550.900** denarë, krahasuar me kompensimin e përcaktuar në të dyja shkallët e vendimmarrjes që në vitin raportues është **3.806.800** denarë.

Duke marrë parasysh të ekspozuarën më lartë mund të përfundojmë se gjyqtarët, këshilltarët gjyqësor dhe të punësuarit në shkresoren pranuese të këtij Sektori, në vitin raportues **2019** kontribuan që Sektori për gjykim në afat të arsyeshëm të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut të jetë i azhurnuar dhe efikas, duke marrë parasysh numrin e lëndëve të shkallës së parë dhe të dytë, sipas të gjitha bazave. Mënyra e këtyre të punës, jep të drejtën që ky Sektor edhe më tej të vazhdojë të punojë me intensitetin e njëjtë të vendimmarrjes së lëndëve në afat të arsyeshëm me vendime kualitative, me përpjekje për zgjidhjen e çështjes rreth dorëzimit të shkresave të lëndëve për të cilat është parashtruar kërkesë për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm.

5. Sektori i praktikës gjyqësore në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, **në vitin 2019** i realizoi detyrat sipas planit programues.

Nevoja për transparencën, parashikimin dhe respektimin e principit të sigurisë juridike, e determinon punën e Sektorit të praktikës gjyqësore edhe në vitin 2020, të qëndrojë dhe të thellojë rolin e tij në barazimin për zbatimin e ligjeve nga ana e gjykatave.

Për realizimin e qëllimeve dhe detyrave, në përputhje me rolin dhe vendin e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut si gjykatë më e lartë, që me kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka kompetencë për barazimin e zbatimit të ligjeve nga ana e gjykatave, posaçërisht me zgjerimin e kompetencave të rregulluara me ligjin për gjykatat, ku Mbledhja e përgjithshme e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut ka kompetencë funksionale të veprjohë sipas iniciativave dhe përmes qëndrimeve juridike parimore të unifikojë zbatimin e ligjeve nga ana e gjykatave, nevojitet edhe përkushtim më i madh i gjyqtarëve të Gjykatës, anëtarë të sektorit të praktikës gjyqësore.

Për shkak të realizimit të angazhimeve për transparencën e gjykatës, respektivisht të hapurit e gjykatës për publikun, imponohet nevoja e përpunimit të sistemit për publikimin dhe kërkimin e vendimeve në sistemin e praktikës gjyqësore, përmes seleksionimit dhe kërkimit të tyre për të dhënat kryesore, për të cilën është i domosdoshëm planifikimi dhe investimi në projekt për furnizim, respektivisht futja e mjetit për mundësimin më efikas të kërkimit.

Futja e mjetit për kërkimin e vendimeve të rëndësishme – referente nga ana e gjyqtarëve nga të gjitha gjykatat, me themelimin e bazës për të dhënat – vendime sipas llojit, të disponueshme vetëm për gjyqtarët.

Publikimi rregullisht i vendimeve të gjykatës.

Seleksionimi rregullisht i vendimeve të rëndësishme – referente gjyqësore.

Në suaza të kompetencës funksionale të Sektorit të praktikës gjyqësore, imponohet nevoja edhe për unifikimin joformal të praktikës gjyqësore. Unifikimi joformal i praktikës gjyqësore shihet si këmbim i mendimeve të veçanta juridike dhe përvojë në zbatimin e çështjeve proceduese juridike dhe materiale.

6. Duke marrë parasysh rolin dhe kuptimin e administratës gjyqësore në Gjykatën supreme, si gjykatë më e lartë në Republikë, në procesin për sigurimin e veprimit efikas të gjykatës, të bëhen përpjekje për ndryshimin e Ligjit për shërbim gjyqësor dhe përmes të cilës do të sigurohen mundësi në përparimin, themelimin dhe rritjen e numrit të nëpunësve gjyqësorë.

7. Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në përputhje me kompetencën e saj mendimet juridike parimore dhe qëndrimet juridike parimore, mendimet juridike dhe konkluzionet nga puna e Mbledhjes së përgjithshme dhe mendimet juridike, konkluzionet dhe sentencat e miratuara në mbledhjet e sektorëve, të vazhdojë gradualisht t'i publikojë në UEB faqen e Gjykatës dhe të vazhdojë praktikën me publikimin e Buletinit dhe të Përmbledhjes së vendimeve gjyqësore.

**GJYKATA SUPREME E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
MBLEDHJA E PËRGJITHSHME**